

# HEJZA

209

Rozafa Shpuza, poete dhe fotografe

**E BUKRA DHE E SHËMTUEMJA S'EKZISTOJNË  
PA NJËNA-TJETRËN**

Nën thjerrë

# AKADEMIA E HESHTJES INTELEKTUALE

**Nuk po dëgjohet zëri i intelektualëve tanë, i akademikëve tanë në angazhimin e VLEN-it për të pasur një Akademi shqiptare të arteve dhe shkencës në RMV!**



**Nga Avni HALIMI**

Në BE nuk mund të përfshihen ata shtete që mbahen me ide retrograde, ata vende që këmbëngulin në formimin e shtetit komb. BE-ja nuk mund të shfrytëzohet si çerdhe ku mund të etablohet kjo ide e cila veç konflikteve, spastrimeve etnike, gjenocidit, nuk prodhon asnjë të mirë tjetër! BE-ja tashmë i ka rregullat e veta dhe, të gjithë ata që angazhohen për t'u inkuadruar në këtë Bashkësi, duhet që të heqin dorë nga rregullat vetanake dhe t'i pranojnë gërmë për germe rregullat që i kanë vënë Shtetet e Bashkuara të Evropës.

**Megalomani apo paranojë**

Maqedonia e Veriut nuk mund të pretendojë të futet në BE si shtet trashëgimtarë e lashtësisë së njerëzimit. Për t'ia shuar një ëndërr të tillë u detyrua nga shteti grek që të heqë dorë nga emri i vjetër i shtetit, nga flamuri dhe nga simbolet e përvetësuar nga katalogu nacional i civilizimit grek. Maqedonia u vetë-përrjashtua nga fillimi i bisedimeve me BE-në për hapjen e grup-kapitujve të parë pikërisht sepse po refuzon që të bëjë ndryshime kushtetuese dhe në Kushtetutën e re t'i emërtojë edhe bullgarët e RMV-së si qytetarë të saj. Vetëm Shqipëria nuk i vë kushte! Përkundrazi, me rastin e hapjes së kapitujve me BE-në, në Konferencën e përbashkët, kryeministri shqiptar, Edi Rama, e qortoi Bullgarinë për qëndrimin e saj i cili u bë shkak që Maqedonia të shpërbëhet nga rrugëtimi i përbashkët për t'u inkuadruar në BE! Rama e quajti dështim të Evropës mosvazhdimin përkohësisht të procesit për inkuadrimin e

Maqedonisë së Veriut në BE. Thjesht, për këtë "padrejtësi" evropiane foli me zemër të thyer e gati i përlotur! Janë një mori problemesh me të cilat përballen shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, bashkëkombës të Edi Ramës, të cilët probleme Rama duhet t'i theksojë në çdo event ndërkombëtar! Rama nuk duhet që vullnetarisht të luajë rolin e sponsorit të RMV-së, por të shqiptarëve që jetojnë në këtë shtet e që tejkalojnë 30% në numrin e përgjithshëm të qytetarëve të saj. Maqedonasit e urrejnë gjuhën shqipe! Maqedonasit e urrejnë kulturën shqiptare! Këtë e dëshmuuan edhe me Enciklopedinë maqedonase që e botoi Akademia maqedonase e ku, mbi shqiptarët, vetëm shkencë që nuk kishte, por kryekëput, urrejtje patologjike! Maqedonasit tmerrësisht frikësohen nga intelektualët shqiptarë, rrjedhimisht, edhe nga Institucioni i denjë për grumbullimin e elitës së verifikuar shqiptare - nga Akademia! Sepse, e kanë keqpërdorur Akademinë, janë mësuar me përdorimin e këtij Institucioni në shërbim të politikës ditore, ndaj dhe fort frikësohen nga Akademi "e armiqtve shqiptarë"! Maqedonasit thanë shkurt e qartë - nuk mund të ekzistojë një Akademi shqiptare e arteve dhe shkencës, sepse një Akademi (maqedonase) po ekzistua dhe nuk ka shtet në botë që i ka dy akademi. Por, ama vështirë të gjendet shtet tjetër në botë (veç shteteve sllave-ortodokse) që diskriminojnë intelektualë të tjerë (ekskluzivisht shqiptarë) duke u angazhuar në përjashtimin e çdo intelektual kombëtar që i përket etnisë shqiptare. Akademikët maqedonas nuk janë të gatshëm që të hapin edhe sektorë për gjuhën, për artin, për kulturën e shqiptarëve të Maqedonisë

së Veriut, ku do të angazhoheshin akademikë etnik shqiptar. Ata jo fort larg ishin edhe kundër një Ansambli profesional shqiptar, por ç'të keqe po përjeton Maqedonia e Veriut nga funksionimi tashmë i këtij Ansambli? Çdo gjë institucionale shqiptare është vetëm një vlerë për shtetin e Maqedonisë së Veriut dhe nuk paraqet kurrfarë rreziku mbi qenësinë e popullit maqedonas. Në Maqedoninë e Veriut po funksionuakan rreth 40 institucione nacionale që merren me gjuhën maqedonase, me historinë maqedonase, me kulturën maqedonase e me shkencën maqedonase dhe vetëm një Institut (ITKSH) që merret me trashëgiminë kulturore e shpirtërore të shqiptarëve të RMV-së! Në Maqedoninë e Veriut edhe ajri, uji, fryma duhet të jenë maqedonase! Ja pse kryeministri shqiptar duhet të jetë i lemeritur dhe jo të ligështohet nga kushtëzimi i Maqedonisë së Veriut nga BE-ja për t'u inkuadruar në gjirin e saj. Nuk janë shqiptarët që duan institucione paralele, janë vetë maqedonasit përjashtues që frymëzojnë themelimin e këtyre institucioneve paralele! Akademinë e arteve dhe shkencës e themelon Kuvendi shtetëror dhe është institucion që i shtynë politikën shtetërore apo edhe që u rri çekan mbi kokë! Është paranojë e interesave shtetërore si dhe kasafortë e të arriturave, e sukseseve, e ideve dhe projekteve të shëndosha e të bukura të të gjithë qytetarëve të saj, madje duke u angazhuar që brenda vetes të përfshijë si anëtarë nderi edhe intelektualë nga mbarë bota! Vetëm shqiptarët duhet të përjashtohen! Një akademi eventuale e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut e cila do të finançohej nga komunat

shqiptare është vetëm se një emër i bymyer i një shoqate joqeveritare dhe asgjë më shumë! Ata akademikë që do të kishin pranuar që të startojnë punën akademike në një shoqatë joqeveritare, në fakt vetëm sa do të shndërroheshin në vegla të politikës ditore.

**Rrjetëzimi kulturor**

Një komb i pjekur kulturalisht, tashmë në kushte të reja teknologjike, patjetër që ka krijuar, veç tjerash, edhe një platformë kombëtare përmes rrjetëzimit të shoqatave letrare kombëtare si dhe rrjetëzimit të manifestimeve letrare. Kjo platformë pa dyshim që do të shërbejë për ruajtjen e vlerave të krijimtarisë letrare dhe të emrave të krijuesve kombëtarë. Çka i duhet një shoqërie rrjeti i shoqatave dhe i manifestimeve letrare? Mbi të gjitha, krijohet një vitrinë sirtarësh të qasshme për secilin që dëshiron të njihet me letërsinë, me trendet krijuese si dhe me veprat e autorëve kombëtarë. Në Perëndim këta lloj rrjetesh letrare po shërbejnë edhe si mundësi bashkëpunimi në mes të shkrimtarëve, poetëve, kritikës letrare, me qëllim jo vetëm të njoftimit e të shkëmbimit të përvojave por edhe të nxitjes në krijimin e projekteve të reja. Shoqatat e shkrimtarëve të përfshirë nëpër rrjete gjegjëse, duke organizuar ngjarje e manifestime të përbashkëta që përkujtojnë veprat dhe autorët e njohur, në fakt, po ndihmojnë në ruajtjen e kulturës dhe historisë letrare. Tashmë ky angazhim në drejtim të këtij aktiviteti kombëtar po bëhet tepër i rëndësishëm sidomos për të rinjtë që mund të humbasin lidhjen me trashëgiminë e tyre kulturo-letrare. Gjithashtu, këto rrjete tashmë si platformë të etabluara gati në

institucione nacionale, po ia dalin që të organizojnë edhe lexime publike, diskutime dhe panaire libri, ndërsa e gjithë kjo po rritë interesimin te publiku për të eksploruar më shumë krijimtari letrare. Pra, formimi i rrjeteve të shoqatave letrare kombëtare dhe i manifestimeve letrare po kuptohet si nevojë jetike për ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave të krijimtarisë letrare. Me këtë po rritet ndërgjegjësimit kombëtar për rëndësinë e letërsisë dhe krijimtarisë në jetën e përditshme, duke e bërë atë një pjesë të rëndësishme të kulturës shoqërore. Fatkeqësisht, bota shqiptare edhe në këtë plan vonon shumë, sikur më lehtë e ka që të influencohet nga ndikimet e jashtme, pa u shqetësuar fare nga shpërqendrimi nga letërsia e vërtetë e duke u dhënë pas bestseller-ave limonadë ! Përfundimisht, formimi i platformave nga rrjetet e shoqatave letrare kombëtare dhe të manifestimeve letrare është esencial për ruajtjen e vlerave të krijimtarisë letrare dhe të emrave të njohur të krijuesve kombëtarë. Pa dyshim që, këto rrjete, do të ndihmonin, veç tjerash, në ndërtimin e një kulture letrare aktive dhe të angazhuar, duke e bërë letërsinë një forcë të rëndësishme në zhvillimin e shoqërisë dhe identitetit kombëtar. Faktorët dhe institucionet gjegjëse kombëtare formimin e këtyre rrjeteve duhet ta kuptojnë si detyrë kombëtare para një ngutje marramendëse botërore

në digjitalizimin e letërsisë dhe në përfshirjen e krijuesve kombëtare në platformë ku, definitivisht, nuk do të ketë vend për pseudo-krijuesit. Nuk duhet harruar që një aktivitet të tillë do të mund ta zhvillonin edhe pseudo-krijuesit, porse, në platformat e tyre pastaj nuk do të kishte vend për krijuesit bashkëkohorë kombëtar. Bota letrare do të nisej nga niveli i tyre për të krijuar një perceptim mbi letërsinë bashkëkohore shqiptare. Kjo është përparësia që e ofron koha e teknologjisë: vlera ta bllokojë antivlerën dhe, e kundërta, antivlera të shitet si vlerë!

#### Armiqtë e kulturës letrare shqiptare

Manifestimet letrare janë aktivitete që i kushtohen krijuesve letrar, por dhe respekt që në mënyrë të organizuar shprehet për vlerat dhe për të arriturat në sferën e krijimtarisë letrare. Atëherë, çfarë mund të jenë e kundërta e kësaj? Çfarë paraqet pseudo-manifestimi letrar? Sot, kritika bashkëkohore letrare konstaton se letërsia jonë ka nevojë për inovacion dhe sinergji dhe në emër të kësaj shpesh po përballemi me do aktivitete që po na shndërrohen në dukuri shqetësuese: me pseudo-manifestime letrare, në të cilat kryesisht vlon antivlera si dhe promovohen ide dhe prirje të cekëta sa për të shprehur "kreativitetin" e një grupi që pretendohet si letrar. Çuditërisht, kritika po hesht dhe nuk po

i vë në shënjestër rreziqet që paraqiten nga këto dukuri! Të paktën të flitet për mungesën e origjinalitetit që vërehet nëpër pseudo-manifestimet letrar, që po organizohen nëpër mëhalla, nëpër oda, nëpër katunde e nëpër paralagje, në të cilat "manifestime" nuk po ndodhë asgjë përveçse po riprodhohen idetë e vjetra, tendencat e tejkaluara dhe kjo po shëmbëllen në riciklimin e qëllimshëm në format dështuese "letrare". Krejt në fund, në mënyrë "të pavetëdijshme" po kontribuohet në devalvimin e manifestimeve të mirëfillta letrare me karakter lokal, shtetëror e mbarëkombëtar. Çfarë po ndodhë në të tilla pseudo-manifestime? Po shtyhen përprjetë me kunja ca emra që kanë nevojë për "famë aktuale", që janë ithtarë të "poezisë aktuale" dhe jo të aktualitetit të përhershëm të poezisë! Kjo pastaj po e nxitë detyrimisht përjashtimin e zërave autentikë, të atyre krijuesve të kohës që sjellin perspektiva të fuqishme letrare. Mbi të gjitha, këto pseudo-manifestime letrare ashfaqe po ngjasojnë në një shfaqje marketingu, duke vendosur para artit interesat financiare. Po flitet se nëpër "evente" të tilla po shiten blihen, po financohen e sponsorizohen "shpërblime" e "dekorata" që mund t'i ofrojnë vetëm "mjeshtrit themelues" të pseudo-manifestimeve të tilla. Këta "mjeshtrë" kanë edhe një afinitet të çuditshëm: thirren në emra të krijuesve të mëdhenj, lexojnë e citojnë

autorë të njohur kombëtar, me qëllim që ta realizojnë synimin e tyre: të anashkalojnë dhe t'i ngulfasin talentet e rinj dhe mjeshtrit e krijimtarisë poetike bashkëkohore, si dhe të promovojnë "poetë" sa për ta tërhequr një "të anatemuar" që do t'i bëhen publik besnik i pseudo-manifestimit. Pra, pseudo-manifestimet letrare në vend që të mbështesin një zhvillim të vërtetë dhe të thellë të letërsisë, ata, veç tjerash, përfaqësojnë një rrezik të madh për komunitetin letrar. Është e nevojshme që artistët dhe organizatorët e ngjarjeve letrare të rikthehen në vlera autentike, të inkurajojnë zërat e rinj dhe të promovojnë një dialog të sinqertë dhe krijues midis autorëve dhe lexuesve. Kjo në të mirë të integritetit të letërsisë që është një amanet për çdo komunitet letrar i cili duhet të rishqyrtojë dhe të mbështesë ngjarjet që frymëzojnë dhe nxisin kreativitetin, që fokusohen në autenticitetin dhe thellësinë e shprehjes artistike. Por, ka edhe nga ata matrapazë që pseudo-manifestimet i organizojnë sa për ta përqendruar vëmendjen te autorët e rinj dhe eksperimentalët, sepse besojnë fort se rinovimi është çelësi për të tërhequr audiencën. E bëjnë këtë "fokusim" vetëm sa për të përjashtuar emra që kanë kontribuar me vepra të jashtëzakonshme dhe të pavdekshme. Pa dyshim, të këtillet lirisht mund të vlerësohen si armiqtë e kulturës letrare shqiptare.

## Letër nga diaspora

# FORCA CENTRIPETALE

**Janë disa "artistë", të cilët, në emër të artit shqiptar, gjejnë forma të ndryshme dhe abuzojnë, duke i hapur shteg vlerave të dyshimta**

#### Neviana SHEHI/ Itali

Artistët e diasporës shqiptare gjithnjë e më shumë marrin një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e kulturës sonë në mbarë botën. Tashmë është i njohur kontributi i tyre në letërsi, arte vizual, muzikë, teatër, film etj., kontribut ky që jep shtysë në mbajtjen gjallë të identitetit kulturor dhe trashëgimisë së shqiptarëve, si dhe duke ndikuar në skenën artistike ndërkombëtare. Natyrisht, përmes veprimtarisë së tyre, disa nga artistët e diasporës krijojnë ura ndërmjet kulturës shqiptare dhe asaj ndërkombëtare. Kjo krijon një ndërveprim të dyanshëm, me ç'rast publiku i huaj mëson për Shqipërinë, Kosovën dhe shqiptarët në përgjithësi, ndërsa artistët tanë përvetësojnë ndikime të reja nga kultura dhe estetika të huaja. Është një numër i konsiderueshëm i artistëve shqiptarë të diasporës, të cilët kanë arritur sukses të madh në nivel ndërkombëtar dhe kjo, kuptohet, si komb na nderon shumë. Fatkeqësisht, krahas artistëve të ndërgjegjshëm dhe me taban kombëtar, kemi edhe anën tjetër të medaljes. Janë disa "artistë", të cilët, në emër të artit shqiptar, gjejnë forma të ndryshme dhe abuzojnë, duke i hapur shteg vlerave të dyshimta, të cilat në masë të madhe jo vetëm që krijojnë huti, por edhe cenojnë atë që është prodhim i vërtetë i shpirtit të artistit shqiptar. Duke mos pasur pikë ndërgjegje, ne sot jemi dëshmitarë të shumimit



si kërpuha të lloj - lloj "artistëve", të cilët, për interesa të ndryshme (kryesisht materiale), katapultohen nga disa individë, që në fakt errësojnë vlerat e vërteta në njërin anë dhe në anën tjetër i ushqejnë me iluzione "artistët" anonimë se do të mund të shpërthejnë deri në marrjen e Çmimit Nobel apo të ndonjë çmimi tjetër ndërkombëtar.

Kjo, mbase është edhe pasojë e mungesës së një mekanizmi kontrollues, jo në kuptimin e dorës së fortë, por në kuptimin e ndarjes së të mirës nga e keqja, gjë që do të ndikonte në ndërgjegjësimin e të gjithë atyre që ia mësyjnë që përmes rrugës së shkurtë të arrijnë në lartësitë e konsiderueshme. Abuzuesit shesin flatra të padukshme dhe me to nuk lëvizet as nga pika zero, përkundrazi edhe nëse lëvizet, shkon në humnerë. Pra, duhet të ekzistojë një forcë centripetale, koordinuese, që do t'i mbajë artistët të bashkuar rreth idesë se kultura shqiptare është një dhe e pandashme dhe se ka një rend, ka njerëz kompetentë, me përgatitje superiore dhe që janë në rrjedha të zhvillimit të artit. Në këtë rrafsh amatorizmi do të ishte vetëm në shërbim të injorancës dhe lënies së shijes së keqe.

Prandaj, të qenët i ndërgjegjshëm dhe i moralshëm na largon nga forca centrifugale që do të na përplaste sa më larg boshtit tonë, rreth të cilit ndërtohet identiteti ynë kombëtar dhe anës shpirtërore të vërtetë që është prodhuese e vlerave të qëndrueshme, të cilat mund t'ia prezantojmë botës gjithandaj ku jetojmë e veprojmë...

Nobeli për letërsi, 2024

# ROMANET E HAN KANG

Jeni kurioz për laureaten e letërsisë së vitit 2024, Han Kang, por nuk jeni të sigurt se cilin nga librat e saj të merrni më parë, Steve Sem-Sandberg nga Akademia Suedeze jep rekomandimet e tij...



**VEGJETARIANIA:** është romani i cili fitoi çmimin "International Booker Prize" në vitin 2016. Është historia e një gruaje koreane e moshës së mesme, e cila një natë befasisht vendos të mos hajë më mish. Vetë vegjetariana hesht në roman. Historia e saj tregohet në tre rrëfime të ndryshme nga i shoqi, kunati dhe motra e saj e madhe (në atë radhë). Reagimet e tyre të ndryshme, nga neveria te magjepsja seksuale dhe zilia helmuese, janë në kontrast të thellë me refuzimin memec të vetë gruas për t'u tërhequr ose për të pranuar ndonjë faj për turpin që i ka sjellë familjes së saj. Nëpërmjet këtyre përgjigjeve ne marrim një portret të mprehtë të një shoqërie patriarkale, të fiksuar nga karrierizmi dhe normat e konventat shoqërore të ngurta ndonjëherë dhe tiranike.

**MËSIMET GREKE:** ky roman i shkurtër, por intensiv dhe depërtues psikologjikisht, është një portret intim i dy individëve që kanë humbur, ose janë në proces të humbjes se hallkave më vitale që i lidh me botën e jashtme. Pasi ka vuajtur nga abuzimi në familje, protagonistja femër është tërhequr në heshtje, ndërsa protagonist i mashkull dalëngadalë humb shikimin për shkak të një sëmundjeje trashëgimore. Për të rifituar aftësinë e komunikimit, gruaje ndjek kurse në greqishten e vjetër – pasi një gjuhë që nuk flitet më nuk mund ta lëndojë atë – ndërsa burri që humb shikimin është mësuesi i saj i greqishtes. Një lloj historie delikate dashurie. Romani gjurmon përpjekjen e tyre për ta kapërcyer nëse jo kështu, të paktën të përpiqen të gjejnë gjuhën e përbashkët në humbjen e tyre të përbashkët. Është

gjithashtu një libër për gjuhën, se si fjalët mund të na ndihmojnë t'i japim formë dhe kuptim botës sonë të jashtme dhe të brendshme, por edhe të shkëpusin dhe shkatërrojnë atë që është më delikate te të gjithë ne: identitetin tonë.

**VEPRAT NJERËZORE:** Ashtu si në romanin e saj të fundit, "Ne nuk ndahemi", i planifikuar për botim në anglisht në janar 2025, "Veprat njerëzore" hedh një vështrim të zhdrejtë, por të frikshëm dhe plotësisht bindës në të kaluarën jo aq të largët të vendit të saj. Nëpërmjet shumë këndvështrimeve të ndryshme gjithnjë e në ndryshim, të cilat krijojnë një pezullim tregimtar pothuajse të padurueshëm, romani tregon jetën e shumë njerëzve ose duke marrë pjesë, ose si viktime të kapur pafajësisht në një kryengritje

studentore në maj 1980 në qytetin

e Gwangju, ku autorja kaloi fëmijërinë dhe rininë e hershme, një kryengritje që u shtyp brutalisht nga junta ushtarake e atëhershme në pushtet. Ashtu si në shumë vepra të tjera të saj, kufiri midis dhunuesit dhe viktimës, trupit dhe shpirtit, apo edhe midis të gjallëve dhe të vdekurve, është i luhatshtëm, gjë që pasqyrohet në një gjuhë sa të drejtpërdrejtë dhe delikate. Han i jep në këtë dhe në disa romane të tjerë një kuptim të ri shprehjes "të jetosh me të kaluarën", e konsideruar si mbetje e një realiteti që as nuk mund t'i shmangesh dhe as t'i rezistosh. Nëpërmjet veprave të saj letrare të ndryshme dhe vërtet mahnitëse, ne jetojmë dhe rijetojmë vazhdimisht të kaluarën tonë. (www.nobelprize.org)

**Përgatiti: Fitim Nuhiu**

## Recension

## NJË MEMOAR I SHPIRTIT MALËSOR

Pashko R. Camaj, Porosia e kullës, shqipëroi: Nikollë Camaj, Shtëpia botuese: Onufri, Tiranë, 2024.

## Albert BIKAJ

Autori i librit "Porosia e kullës" Dr. Pashko R. Camaj u lind në Malësi, Mal të Zi në vitin 1964 ku edhe përfundoi shkollimin e mesëm dhe shërbimin e detyruar ushtarak, asokohe në Jugosllavi. Ai sikurse shumë bashkëvendës të tjerë të tij mori rrugët e mërgimit, duke u shpërngulur në SHBA ku më pas do vazhdonte studimet, duke marrë gradën e doktorit të shëndetësisë publike në Universitetin e Kolumbias. Aktualisht është ndihmës-profesor në Universitetin William Paterson në Nju Xheri si dhe sekretar i Federatës Panshqiptare Vatra. Është autor i shumë punimeve shkencore të vlerësuara ndërkombëtarisht, ndërsa ky është libri i tij i parë i botuar fillimisht në gjuhën angleze në titullin "Dreaming from the trunk of an American car" (Duke ëndërruara nga bagazhi i një makine amerikane"). Thënë shkurt, dr Camaj është një nga intelektualët më të shquar malësorë në SHBA-a. Siç thoshte poeti dhe filozofi francez, Paul Valéry, përkthimet më të mira janë si xhami i dritares, nuk vërehen. Kështu që po të mos ishte shënuar emri i përkthyesit – prof. Nikollë Camaj, të cilin e përgëzoj – do të pandehej me të drejtë se kemi të bëjmë me një vepër origjinale të shkruar në shqip. Titulli i dyfishtë i librit, i pari nga origjinali dhe i dyti nga përkthyesi, reflektojnë simbolikën sublimë të këtij memoari, duke përfaqësuar përkatësisht fillimin dhe fundin e rrëfimit: fillimi në bagazhin e një makine në Meksikë ndërsa përfundimi me kullën e tij në vendlindje. Rrëfimet e Pashko Camajt paraqesin në mënyrë të veçantë përvojën e tij personale, por reflektojnë edhe realitetin e shumë shqiptarëve, veçanërisht bashkëvendësve tanë malësorë, të cilët emigruan në ndjekje të ëndrrës amerikane. Dr. Pashku është një nga ata që mund të thuhet me plot gojën se e realizoi atë.

Siç thekson me të drejtë në parathënien e librit shkrimtari Besnik Mustafaj, nuk kemi të bëjmë vetëm me kujtime apo një memoar, por shumë më tepër

## PASHKO R. CAMAJ

## Porosia e kullës

Parathënie nga Besnik Mustafaj

OnufriKujtime



se kaq. Estetika e narracionit elokuent e Pashko Camajt, e denjë për një shkrimtar të klasit të lartë, ndërthur në mënyrë të magjishme e natyrshme stilin e letrarizuar dhe zhanret e ndryshme. Për më tepër, në memoarin e tij hasim ndërthurjen e kujtimeve në disa nivele: personale-familjare, kolektive-lokale-kombëtare, të cilat përçojnë histori dhe emocione të fuqishme. Në rrëfimet e tij të thella e të kujdesshme, sa emocionale aq edhe filozofike, mbi të gjitha realiste, lexuesi nuk mund të mbetet indiferent. Përjetimet e tij dhe të familjes së tij janë aq të forta, sa që ndonjëherë lexuesi e ka të pamundur të mos derdhë lot. Autori, si shumica e emigrantëve, përndiqet nga ndjenja e mundimshme e pyetjes thuajse "hamletiane", nëse ka mëkatuar duke braktisur atdheun. Ndonëse rrethanat e vështira të kohës, që pasqyrohen në kronologji të ndryshme – jeta në sistemin totalitar si komunizmi, diskriminimi, urrejtja, shtypja, varfëria e deri te problemet e tjera sociale – japin kontekst të mjaftueshëm. Gjithsesi, duhet theksuar se të gjitha vështirësitë, sado të dhimbshme, rrëfehen me dinjitet, të shoqëruara nga drita e shpresës hyjnore, stoike – e cila në njëfarë mënyre e ka formuar karakterin e autorit, rrëfimit por edhe vetë identitetin e malësorit. Për më tepër, një lexim kontekstual filozofik i memoarit të Camajt, besimi në virtyt dhe Zoti si koncept metafizik, janë çelësi themelor për të kuptuar karakterin dhe virtytet e larta tradicionale malësore – të cilat i paraqet me mjeshtëri.

Për ta përfunduar, duke pasur parasysh diapazonin e gjerë të rrëfimeve në fjalë, jam i mendimit se vlera e këtij libri i tejkalon kufizimet e klasifikimit modest si kujtime apo memoar, pasi në të autori shpalos jo thjesht rrëfime personale, por përshkruan artistikisht dhe autentikisht ngjarje me vlerë të madhe kulturore për sa i përket së kaluarës së Malësisë. Duke filluar nga jeta e dikurshme e përditshme, ngjarjet, ceremonitë, doket, zakonet, rrethanat politike, etapat historike dhe gojëdhënat e mikrokozmosit tonë...

## HOMOGENIZIMI I LETËRSISË

Arti, në esencën e tij duhet të sfidojë veten dhe sistemet e vendosura të mendimit dhe përvojës. Kur një kritik e vendos një autor të ri në kornizën e një autori të njohur, ajo që ndodh është një lloj ngurtësimi estetik

## Enida Sheshi HAXHI

Kur kritikët i krahasojnë autorët e rinj ose veprat e tyre me ato të shkrimtarëve të njohur, shpesh ndodh një homogjenizim i artit letrar. Letërsia nuk është më një fushë ku çdo vepër qëndron si një entitet më vete, por bëhet një lojë referencash dhe lidhjesh, që kufizojnë leximin në skemat e së shkuarës. Për shembull, të krahasosh një roman të ri me një vepër të klasikëve, shpesh nënkupton se autori i ri nuk ka krijuar një botë të vetën, por thjesht ka marrë një "recetë" të një autori tjetër dhe e ka zbatuar atë. Kjo gjë jo vetëm që zvogëlon rëndësinë e krijimit të tij, por e detyron lexuesin ta shohë veprën përmes filtrave të tjerë, të huaj për universin e saj unik. Lexuesi detyrohet të kërkojë ngjashmëritë me një figurë tashmë të vendosur, në vend që të shohë atë që është e re dhe e ndryshme. Krahasimi krijon një kornizë të ngushtë për vlerësimin e një veprë letrare. Kritiku, në vend që të merret me veçantitë e subjektit, stilit dhe ndërtimit të veprës, shpesh përqendrohet vetëm në të përbashkëtat e

supozuara me një autor tjetër. Kjo qasje është intelektualisht përtace dhe refuzon të shpalosë diskutime më të thella mbi përmbajtjen e vërtetë të veprës. Në vend që kritika të rrezatojë me ide të reja dhe reflektime të thella, ajo reduktohet në një akt të thjeshtë krahasimi, që nuk shton asgjë të re në diskutim.

## Kur letërsia shndërrohet në stereotip

Arti, në esencën e tij duhet të sfidojë veten dhe sistemet e vendosura të mendimit dhe përvojës. Kur një kritik e vendos një autor të ri në kornizën e një autori të njohur, ajo që ndodh është një lloj ngurtësimi estetik. Vepra nuk konsiderohet më si një akt i pavarur, i cili duhet të shqyrtohet dhe kuptohet në bazë të asaj që ajo përmban, por si një variant i diçkaje që tashmë është paracaktuar. Ky akt është një formë e stereotipizimit, një mënyrë për t'i vendosur kufij një veprimi që, nga natyra e tij, është fluid dhe pa kufij. Për më tepër, e parë nga kjo perspektivë, krahasimi është një mënyrë për të ruajtur status quo-në e mendimit kritik. Në vend që të sfidojë

normat, kritiku, përmes krahasimit, i riprodhon ato, duke i përjetësuar sistemet e njohura dhe të pranuar të vlerësimit estetik. Krahasimi është, në thelb, një kthim në atë që është tashmë e njohur dhe e vendosur, dhe jo një zhvendosje drejt asaj që është ende e panjohur dhe e fshehur. Vepra nuk përjetohet më si një udhëtim drejt të panjohurës, por si një rrugë e ngushtë ku çdo hap është tashmë i shkelur më parë.

## Shpërfillja e të veçantës

Një nga qëllimet kryesore të artit është përjetimi i tjetërsisë, i së pashpjegueshmes dhe i së resë. Krahasimi, megjithëse një akt racionalizimi, shpesh bie në grackën e asimilimit. Duke e lidhur një autor të ri me një paraardhës të njohur, kritiku kryen një akt që e mbyll veprën brenda një strukture tashmë të njohur, duke e mohuar potencialin e saj për të qenë radikalisht ndryshe. Kjonjësi e tjetërsisë që sjell arti – ajo ndjesi që na bën të përjetojmë diçka që kurrë më parë nuk e kemi ndier – shpërbëhet nën

peshën e krahasimeve. Veprat e artit, sidomos tekstet, kanë një potencial për të "dekonstruar" vetë rendin tonë të perceptimit. Krahasimi, në të kundërt, përfaqëson aktin e rikthimit të këtij rendi, duke minimizuar çdo përmbysje të mundshme që një vepër mund të sjellë. Ky është një lloj "dogmatizmi kritik", ku vetëm ato që përshatën në sistemet e vjetra të dijes konsiderohen si të vlefshme për diskutim. Në vend që një vepër të shihet si një akt i veçantë, që lind nga individualiteti i papërsëritshëm i autorit, e shohin atë si një version të riformuluar të së kaluarës. Në këtë pikë, Immanuel Kant, në teorinë e tij mbi gjykimin estetik, ofron një perspektivë të rëndësishme: gjykimi mbi artin nuk mund të mbështetet në formulime të paracaktuara, por duhet të bazohet në përjetimin e drejtpërdrejtë të bukurës dhe sublimes. Letërsia, në thelb, është një akt që fton lexuesin të përjetojë të panjohurën dhe të pakonceptueshmen. Krahasimi, përkundrazi, e zbeh këtë përvojë, duke e bërë veprën të duket si një shtrirje e së shkuarës dhe jo si një zbulim i së resë.

Të fshehta jashtë ekranit

# BREZI I MBYLLUR


**Jeta na ka mësuar që inteligjenca është baza e suksesit në çdo profesion. Edhe një bukëpjekës inteligjent na garanton estetikën e gatimit**

**Mevlan SHANAJ**

Njeriu ka disa nisje në jetë dhe secila nisje ka historinë e vet. Fëmijëria ime ndoshta po të kisha prirje letrare, do të tregohej më bukur përmes prozës. Po kjo nuk do të thotë se filmi nuk e tregon bukur. Kur isha gati 3 vjeç më ka vdekur babai dhe në më pak se dy vjet, na iku edhe vëllai i madh, 25-vjeçar. Të rritesh me një nënë, e cila mbartte dhimbjen e madhe të humbjes së dy burrave të jetës së saj, nuk është edhe aq e lehtë. Ishte një grua e veshur me të zeza, me të cilën nuk i lëshonim duart deri në dorëzimin e pushtetit të gjumit. Ëndrrat tronditëse të kësaj periudhe për mua ishin bërë shqetësim i madh për të, ndaj më mbante gjithë kohën të pushtuar. Kisha edhe dy vëllezër me diferencë moshe. Lëvizjet në qytetin e naftës në Patos, në një qytezë krejtësisht të unifikuar ekonomikisht dhe kulturualisht, krijuan një ndërlidhje sociale të ngjashme me një familje të madhe. Jetohej në të njëjtat kushte, bashkë me të ardhur nga zona sa të ngjashme, aq edhe të kundërta. Të ardhurit ishin nga Mallakstra, Labëria, Kurveleshi, Tepelena, Përmeti, Skrapari, nga Bregu, por edhe nga Çamëria, si dhe një komunitet jo i vogël me çobanë dhe myzeqarë. Në këtë mjedis kishte një harmoni përrallore dhe mirëkuptim të mahnitshëm. Më kujtohet njëherë kur, para një kori nënash me të zeza, një pasdite të kafesë së tyre, vajta me vrap dhe u recitova një vjershë rruge, që brenda kishte edhe fjalë që nuk i kuptoja, por që i deklamova. E kujtoj atë vjershë popullore: "Kola, xha Kola, vreshtin ta vola, rakinë ta piva, çupën ta q..."

Në një kuptim, fillimi i vitit 1950 ishte "paraqitja ime e parë artistike" para grave me të zeza, si kori i tragjedi greke, dhe mora të qeshurat e grave të lagjes, bashkë me duartrokitjet. Kur u bëra 14 vjeç, u shkëputa nga kërthiza e nënës, duke u përzier në një mjedis shumë divers: në Politeknikumin Mjekësor për katër vjet. Gjatë kësaj periudhe të rritjes në konvikt krijohet njohje e lidhje të përziera nga i gjithë vendi. Kulturat e ndryshme në një barazi sociale rritin cilësitë humane të njeriut. Krahas shkollës, tek unë kishte filluar edhe shkolla e jetës, e cila vazhdon derisa të më pulsojë puls. Janë shkenca humane të dyja, vrapojnë për t'i shërbyer njeriut: mjeku për ta riaftësuar, ndërsa arti për ta bërë më të ndjeshëm shpirtërisht e për të pasuruar mendjen. Ndryshimi bazë është se, te mjeku njeriu shkon kur ka shqetësim, ndërsa me artin takohet kur ndihet mirë. Gjetja e urës së komunikimit është siguria e fitores. Hipokrati i thoshte të sëmurit: "Bëhu me mjekun që ta mposhtim sëmundjen, se po u bëre me sëmundjen, ju bëheni dy dhe nuk e mposhtim dot". Edhe ne në art themi: "Eja, se arti është për ty, nuk bëhet për vete. Eja ta ndryshojmë botën. Misioni i artit është përmirësimi i shoqërisë njerëzore".

Arti paraqitet te publiku pas një



përzgjedhjeje të mundimshme. Cilësia në art është domosdoshmëri. Sa më i talentuar artisti, aq më selektiv është. Përvoja jetësore e distiluar kthehet pas një përpunimi të mundimshëm për frymëzuesin. Arti nuk është jetë, por është jeta e ngritur në art, këtë e kryejnë artistët, mjekët zgjasin jetën. Ngjizja me publikun erdhi natyrshëm që nga rolet me karakter popullor, si Ibrahim Kovaçi, që në atë periudhë tipizonte heroinë e fitimtarëve mbi nazifashistët dhe më tej, Nebi Surreli, një përfaqësues nga më të thjeshtët e një shoqërie, të cilët janë shumica. Mendoj se arritja e këtyre karaktereve dhe biologjia, fiziologjia ime si natyrë ka gjetur sintoninë me të fshehtat dhe dihet se të fshehtat, jo pak herë si puna e sekreteve, nuk bëhen me deklarata, por me ndjeshmëri si puna e dashurisë. Publiku me mua apo unë me publikun kemi një lidhje intime memeece: kuptohemi pa bërë titur. Unë më shumë se çdo gjë kam pasur frikë atë që kam dashur më shumë: ruajtjen e respektit dhe moscenimin e dinjitetit reciprok. Unë di ta respektoj publikun dhe ai, mesa duket, di të ndiejë dashurinë me antenat më të ndjeshme pa kurrfarë mandati. Inteligjencën, që në bankat e shkollës, na e kanë ngulitur si pronë të shkencave ekzakte. Mendoj se jeta na ka mësuar që inteligjenca është baza e suksesit në çdo profesion. Edhe një bukëpjekës inteligjent na garanton estetikën e gatimit. Në profesionin tonë supozohet se regjizura duhet të jetë më e kulturuar, më e lexuar dhe më e ditur. Regjizura në film për mua ka qenë si guri i Sizifit, që për ta çuar në majë gurin e stërmundimshëm duhet sakrificë strapacuese, sepse ashtu besonte. Edhe unë kam besuar që gjithë munda, copëtimi i këmbëve, si gjakosja e Sizifit, do të më çonte në majë dhe duhej ta ndërmerrja këtë mision. Sipas Albert Kamysë, ne

duhet ta shikojmë Sizifin të lumtur, kështu i shikon publiku regjisorët e filmit, por ata vetë e dinë se çfarë mundimi është bërja e një filmi. Në çdo film rifillon mbajtja e gurit të tmerrshëm në të përpjetën e madhe me një mundim të ri. Askush nuk mund të thotë se lumturia ka një peshore. Në jetë për çështjet shpirtërore jemi të përveçëm. Ne njohim përvojat, por pa i provuar nuk mund të themi se i zotërojmë. Njeriu për çdo gjë në jetë ose ka dëgjuar, ose ka lexuar, ose ka parë shumë fenomene. Përvoja njerëzore te një krijues vjen përmes informacioneve. Kur je krijues jep përvojën tënde, ndryshe nuk quhesh krijues, por kopjues. Këto përvoja kur kalojnë në procesin krijues, vijnë spontanisht si të reja dhe të besueshme. Njeriu vetëm modelin e vdekjes nuk e ka si përvojë, pasi te vdekja ceket e vërteta, por atë eksperiencë ne nuk e njohim. Nuk na e ka treguar kush. Ndaj arti sillet si i vërtetë, por e vërteta mbetet e paprovuar. Të jesh artist do të thotë të jesh në ngjijtje, nëse mbetesh në një plan apo ripërthypës, humb vëmendjen e publikut dhe, me këtë rast, i ke dhënë vetes dënimin. Ka njeri të gjallë ta pranojë nënshtrimin? Duke huazuar shprehjen e Çehovit lidhur me mjekësinë dhe letërsinë, një tangjente të vockël fare për afërsi profesioni mund ta heq edhe unë: "Akrimi është e dashura ime, regjistra është gruaja". Gjatë përvojës sime të gjatë jam përpjekur të flas me zërin tim, në çdo hap të jetës. Nuk më ka pëlqyer zhurma, por nuk jam pajtuar as me heshtjen. Kam kërkuar të ndiej zhurmat e heshtura, lëvizjet e brendshme, të cilat ashtu si tërmetet, janë të rrezikshme kur shpërthejnë. Këto lloj lëvizjesh të brendshme te njeriu më kanë vënë gjithë jetës në mendime, por jo të gjitha herët kam mbërritur aty që kam dëshiruar.

Rrethanat kanë qenë të ndryshme, por një gjë ka qenë konstante: shpirti im paqësor ndaj njeriut. Por në krijimtari, nëse je paqësor, do të paguash haraçin. Krijimtaria bëhet vetëm nga diktatorët, të cilët krijimin e respektojnë më shumë se çdo gjë tjetër. Krijimtaria nuk nxirret në treg, në kuptimin sa më paguan për këtë apo sa ma shet atë. Tregtia më e dështuar në jetë është kompromisi në krijimtari. Më vrasëse është heshtja, indiferentizmi apo pajtimi me më të fortin, ndërsa unë mendoj se duhet lakmuar cilësia. Mediokriteti në art kultivon shijen e venitjes dhe njerëzit të duken gati njësoj të dehur, të hallakatur nga koka, kur këmbët ecin kuturu. Ne jemi brezi i pasluftës dhe edukimi kulturor e artistik ishte përmes propagandës, pllakateskës dhe çdo gjë ishte e fryrë. Derisa një gjilpërkë e plasi tullumbacen, ajrin e së cilës ata që ishin më pranë vazhdojnë ta thithin edhe sot e kësaj dite. Fillimet e fëmijërisë sime janë me heronj. Filmi i parë argëtues në fund të viteve '50 ishte "Vagabondi". Mendo, deri në adoleshencë, kemi parë veç një përrallë me qilim fluturues apo "Ali Baba me 40 hajdutë"... Vonë, pas viteve '60 erdhi filmi i parë tronditës social, "Rroku dhe vëllezërit e tij" i L. Viskontit. Pra, një brez i zhuritur për shumëllojshmëri dijesh, përveç librave cilësorë që botoheshin, mjetet e tjera shprehëse ishin krejtësisht të mohuara, përveç radios. Mendoj se brezi im, siç u quajt dikur Brezi i humbur, shumë mirë mund të quhej edhe Brezi i mbyllur. Pas lëvizjeve alla-Let it be, alla-Beatles, edhe në vendin tonë filluan të gëlojnë antenat e fshehta nën çati... Let it be, let it be!

(Pjesë nga libri TË FSHEHTA JASHTË EKRANIT, i cili pritet të promovohet më 7 nëntor)

Rozafa Shpuza, poete dhe fotografe

# E BUKRA DHE E SHËMTUEMJA S'EKZISTOJNË PA NJËNA-TJETRËN



**Fotografia fikson një çast, por s'duhet me harrue se në atë shkrepje janë të ngjizuna drita, shpirti, emocioni që përcjell personazhi apo objekti në çastin e përjetësimi**

## Shkëlzen HALIMI

Rozafa Shpuza është lindur në qytetin e Shkodrës, ku më 1856 Pjetër Marubi hapi studion e parë fotografike shqiptare dhe ballkanike, ndaj ajo beson me shpirt se është e bekuar qysh në ngjizje me artin e bukur të fotografisë dhe me balsamin e apostujve të poezisë gege. Ka përfunduar me rezultate të shkëlqyeshme studimet e larta për Gjuhë- Letërsi. Rozafa merret me poezi dhe fotografi. Lidhjet e saja me poezinë dhe fotografinë janë të hershme dhe mund të pohojmë pa droje se kanë ardhur vit pas viti duke u bërë ma të ndjeshme dhe intensive. Rozafa boton së pari "Kohë ikonash" me proza poetike, që pasohet me "Anipse", "Grizhlat" dhe "Nana i qindiste kryq dimnat" me poezi në gegërisht. E veçanta e krijimtarisë së Rozafës është se poezitë kanë një lidhje të pashmangshme me fotografitë që ajo shkrepë. Ka kohë që ka hapur në Shkodër një galeri arti, që është një Odë mikpritëse për artistët kudo në botë.

**HEJZA:** Ku ta gjejmë kufirin mes artit dhe reprodukimit në fotografi?

**SHPUZA:** Sikur të ekzistonin kufijtë, nuk do të kishte ma art. Kurrë nuk e mendoj artin, kësaj edhe fotografinë që asht kahu ma i brishtë i tij, të ndamë me kufij. Fotografia fikson një çast, por s'duhet me harrue se në atë shkrepje janë të ngjizuna drita, shpirti, emocioni që përcjell personazhi apo objekti në çastin e përjetësimi. Si mund të quhet art një fotografi, kur duhet me e spjegje me fjalë? Fotografia flet me heshtje, me kontraste dritëhijesh, me mbivendosje ndjesish, me aftësinë e fotografit për me fiksue diçka që të tjerëve u ka kalue pa e vu re. Në këtë botë kaq konfuze asht bekim që ekziston arti i bukur i fotografisë. Sa e varfër kishte me kenë kjo botë pa fotografinë!

**HEJZA:** Cila është bota e fotografit në çastin e shkrepjes së aparatit para të bukurës?

**SHPUZA:** Ekzistojnë disa ndjesi që nuk mund të shpjegohen me fjalë. Ato janë pjesë e qenies, anipse shfaqen spontanisht pa pasë nevojë për miratimin e artistit. Para së bukurës hapat ndalen, aparati mbështetet në mollzën e faqes, syni ngjeshet në atë ditarezen që ta përcjell vështrimin tutje dhe fryma ndalet. Çak... dhe ajo bukuri përjetësohet, tue u ba pasuni në arkivin e fotografit. Fotografi shkrepë aparatit për me mbushë shpirtin, pa mendue për fatin e asaj fotografie dhe kjo asht bota e tij, pa ma të voglin kompromis.

**HEJZA:** E shëmtuara si kryevepër! Sa është provokues ky fenomen estetik të fotografët?

**SHPUZA:** E bukura dhe e shëmtuem-

ja janë dy dukuri estetike që s'mund të ekzistojnë pa njëna-tjetrën dhe s'mbahet mend qysh kur njerëzimi kalamendet në këtë vorbull, pa ditë me përcaktue saktë se ku fillon njena e ku mbaron tjetra. Viktor Hygo e ka cilësue shëmtinë si një detaj i një të tane të madhe, e cila na ikën, s'mund ta rrokim, dhe që asht në harmoni, jo me njeriun, por me të gjithë krijimin. Kësisoj artistët s'rreshtin tue u rrekë me rrokë të shëmtuemen për me e kthye në kryevepër. Besoj se kur janë ma të diskutueshme, dukuritë estetike bahen ma atraktive dhe ma të pëlqyemet nga artistët për me i ba pjesë të artit të tyne.

**HEJZA:** Si duket sot bota e fotografisë artistike. Kah po shkon ajo?

**SHPUZA:** Kam ndjesinë se bota e fotografisë po popullohet përditë e ma shumë me adhures të fotografisë. Rrallë gjen një person që nuk ban fo-

tografi me celularin e vet. Pra, sot fotografia asht arti ma afër njerëzve, ma i perceptueshmi dhe ma i pëlqyeshmi. Lëvrimi i fotografisë artistike ka marrë një hov të papamë, kjo ndoshta edhe falë zhvillimeve marramendëse të teknologjisë, por, thellë- thellë, kam bindjen se fotografia artistike ka nevojë për shpirt e jo për teknologji.

**HEJZA:** Në historinë e fotografisë artistike fotografët shqiptarë zënë vend jashtëzakonisht të meritueshëm.

**SHPUZA:** Unë jam shkodrane, kësaj veç me përmendë Marubin i kam thanë tana, kështu që nuk po zgjatem ma shumë në këtë përgjigje, pasi mendoj se fama marubiane asht e padiskutueshme.

**HEJZA:** Ku janë sot fotografët shqiptarë? Sa janë të përkushtuar pas këtij pas këtij pasionit. Ku është sot fotografia shqiptare?

**SHPUZA:** Kur vjen puna te statistikat, unë nuk e ndjej vedin të aftë me dhanë përgjigje të sakta, mirëpo, e tham me bindje, se fotografët shqiptarë zajnë një vend të merituem në artin e fotografisë botnore. Kurgja nuk po bajnë politikat shtetnore për nxitjen apo përkrahjen e artistëve. Fotografia shqiptare ekziston vetëm falë pasionit të individëve. Për me kenë ma realiste, po ju rrëfej se unë kam hapë një galeri arti në Shkodër, ku, përveç ekspozita personale të fotografëve, çdo vit të ri organizoj një ekspozitë fotografie me fotografët shqiptarë që jetojnë në vende të ndryshme të botës. Janë fotografë të mirënjohun, të talentuem, të apasionuem mbas artit të bukur të fotografisë dhe vëmendja e publikut artdashës asht e padiskutueshme. Kur artdashësit magjepsen nga fotografia jote, kjo asht përgjigja ma e mirë për çdo artist...



Nga Arkivi

# SHKRIMTARËT E PREFERUAR DHE DISIDENCA E BLOKUAR

**Shërbimet e posaçme të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë merreshin me “raporte kulturore” për të monitoruar përhapjen e ideve dhe informacionit që mund të ndikonte në stabilitetin politik të regjimit si dhe në njollosjen e vlerave soc-realiste**



**Nga Avni HALIMI**

Janë të shumtë dokumentet arkivorë nga Arkivi Shtetëror Shqiptar që flasin për iniciativat ndërshtetërore për bashkëpunim në mes të Shqipërisë dhe Jugosllavisë në sferën e arsimit dhe të kulturës, të cilat u iniciuan kryesisht në fillim të vitit 1970 e tëhu, deri më vitin 1981 kur pas demonstratave në Kosovë do të ndërpritet çdo komunikim me Shqipërinë. Në shumë nga këto dokumente vërehet angazhimi dhe serioziteti kombëtar i institucioneve shtetërore shqiptare, të inteligjencies shqiptare, të diplomacisë kombëtare që këto marrëveshje të jenë ekskluzivisht në të mirë të shqiptarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë e që duhet të zhvillohen në frymë të soc-realizmit!

Natyrisht, qëndrimi i palës shqiptare përcillte mesazhe kryekëput politike, duke ia bërë të qartë palës jugosllave se vetëm Kosova dhe shqiptarët e viseve të Jugosllavisë mund të jenë urë komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve respektive. Kurse pala jugosllave gjithnjë ka këmbëngulur në përpjekjet e tilla për marrëveshje bilaterale që nga bashkëpunimet ndërshtetëror të përfitojnë proporcionalisht sa shqiptarët aq edhe kombet e tjera jugosllave. Meqë pala shqiptare nuk është pajtuar asnjëherë me të tilla propozime jugosllave, Jugosllavia gjithnjë ka refuzuar të nënshkruaj marrëveshje për bashkëpunim kulturor në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.

Këmbime të aktiviteteve kulturore në mes të Shqipërisë dhe Kosovës ka pasur falë marrëveshjeve ndër-institucionale arsimore e kulturore që ishin nënshkruar në mes të katedrave/fakulteteve të gjuhës dhe letërsisë, përmes shoqatave të shkrimtarëve të Tiranës dhe Prishtinës, përmes ansambleve kulturo-artistike, shoqatave arkeologjike etj.

**Raporti “sekret” mbi botimet e “RILINDJES”**

Në këtë periudhë do të nisë edhe shkëmbimi i parë i botimeve mes Shqipërisë dhe Kosovës, pas arritjes

së marrëveshjes në mes të Redaksisë së Botimeve të “Rilindjes” në Prishtinë me Ndërmarrjen e Librit e të Filmit të RPSSH-së në Tiranë. “Rilindja” do të botojë përtej asaj çfarë i ofrohej nga Tirana zyrtare. Do ta botojë veprën “Nga jeta në jetë – Pse?!” e cila atëbotë nuk shënohej madje as në bibliografinë e Sterjo Spasses, do të botohet kolona prej 10 vëllimeve të Petro Markos, kolonë kjo që në Tiranë nuk ishte as sa gjysma e asaj që u botua në Prishtinë, botimi luksoz i veprave të Eqrem Çabejt etj.

Në bazë të një dokumenti të deklasifikuar më 28. 07. 2023 në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, vërehet se si përzgjedhësit shqiptarë që propozonin se cilat vepra dhe cilët autorë shqiptarë nga Kosova të botohen në Shqipëri, sugjeronin që këto botime duhet të redaktohen (censurohen) dhe të hiqen ato pjesë të përshtatshme për sistemin e kohës.

Dokumenti në fjalë, i vitit 13.02.1981, i cili kualifikohet si sekret, është një raport (i autorit Ajet Haxhiut), i cili fillon me nënvizimin e numrit të botimeve nga “Rilindja” për vitin 1980. Sipas raportit në fjalë, në këtë vit ishin botuar 175 tituj nga fusha të ndryshme, ndër të cilët numri më i madh ishte i autorëve nga Shqipëria dhe Kosova. Sipas raportuesit, gati çdo botim arrinte tirazhin prej 5000 ekzemplar. Raportuesi nënvizon kompletin e librave të Ismail Kadaresë, një vepër të Dritëro Agollit, librin e Alfred Uçit “Estetika, Jeta, Arti”, si dhe thekson se gazetave të Kosovës kanë botuar edhe recensione dhe artikuj të ndryshëm mbi këta autorë. Po ashtu, raportuesit flet edhe për botimet e planifikuara për vitin 1981. Do të botohen rreth 150 vepra, prej të cilave 75 vepra do të jenë të autorëve shqiptarë: 50 nga Kosova e 25 nga Shqipëria, si: Eqrem Çabej “Gjuhësia indoevropiane”, Mahir Domi “Vepra të zgjedhura”, Selman Riza “Studime albanistike II-III”, Gjergj Zheji “Vështrime metrike”, Fan Noli “Vepra e plotë”, Ndre Mjeda “Vepra e Plotë”, Dritëro Agolli “Vepra të zgjedhura”, Zija Çea “Tregime të zgjedhura”, Xhavadhi Spahi “Poezi të zgjedhura”, “Petro Marko

“Hasta la Vista”, Skënder Drini “Shembja e idhujve” etj.

Autori i dokumentit tërheq vërejtjen se, ndonëse edhe në Shqipëri ka pasur botime e artikuj shkencorë nga autorët kosovarë, megjithatë, nuk është bërë aq sa duhet. “Kuptohet, ata mund të botohen me ndonjë shkurtrim e parathënie të nevojshme”, thotë raportuesi në dokumentin katërfaqësh, duke sugjeruar botimin e këtyre autorëve kosovarë: Zekeria Cana “Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë më 1908-1912”, Zef Mirdita “Dardanët”, Mark Krasniqi “Gjurmë dhe gjurmime” dhe Hivzi Islami “Popullsia e Kosovës”.

Raportuesi e përfundon raportin duke shprehur habinë se si, edhe pse që nga viti 1979 i kishte propozuar SHB “Naim Frashëri” që të botonte ndonjë poet serb, kjo nuk kishte ndodhur akoma!

**“Kujdestarët kulturor” si pararojë të regjimit**

Jo vetëm ky dokument, por edhe sërë të tjerash të kësaj natyre, flasin për angazhimin e “kujdestarëve kulturorë” që botimi i autorëve në të dy vendet respektive të bëhej vetëm pasi ata të kenë kaluar verifikimin shtetëror të institucioneve gjegjëse të sistemit. Asnjë autor disident, bohem e “rebelues” të Kosovës nuk mund të propozoheshin për botim në Shqipëri. Prandaj, deri në rrënim të sistemit totalitar shqiptar, në Shqipëri lexuesi shqiptar asgjë nuk dinte për Adem Demaçin, për Teki Dervishin, Ibrahim Rugovën, për Mirko Gashin, Sabri Hamitin, Ymer Shkrelin, Anton Pashku, Zejnulla Rrahmani, IdrizAjetit, Rexhep Qosjes, Ali Hadrit etj. Pra, regjimi shqiptar preferonte të botojë autorë shqiptarë që ishin të pranueshëm në sistemin jugosllav për disa arsye strategjike dhe politike, sepse: a) duke promovuar autorë që ishin të njohur dhe të pranueshëm në Jugosllavi, Shqipëria përpiqej të mbante një marrëdhënie më të qëndrueshme me fqinjët e saj jugosllavë, dhe me këtë sadopak të minimizoheshin tensionet politike; b) regjimi shqiptar i shihte këta autorë kosovarë si një mënyrë për

të forcuar identitetin shqiptar bazuar në vlerat socialiste si dhe për të promovuar vlera kulturore që ishin të pranuar edhe nga jugosllavët, duke e bërë kështu letërsinë dhe shkencën kulturore si mjet komunikimi “të të njëjtës ideologji”; c) duke zgjedhur autorë “shtetëror”, regjimi shqiptar kishte më shumë mundësi të kontrollonte përmbajtjen dhe mesazhet e publikuara, duke siguruar që ato të ishin në përputhje me ideologjinë zyrtare dhe të mos rrezikonin stabilitetin në rajonin komunist; dhe, d) autorët që ishin të pranuar nga regjimi jugosllav tashmë kishin krijuar lidhje dhe rrjete që mund të ishin të dobishme për Shqipërinë për të promovuar letërsinë shqiptare jashtë kufijve të saj.

**Soc-realizmi shqiptar preferonte poetë serb**

Raportuesi në këtë dokument ka sugjeruar që të botohet ndonjë poet serb! Sepse, nga Jugosllavia po përhapej propaganda se vetëm serbët janë për ruajtjen e vlerave komuniste, ndërsa sllovenët jo, sepse ata kishin nisur të propagoheshin si “shoqëri perëndimore”, kroatët po sulmoheshin si kolaboracionistë të ustasëve që po angazhoheshin për shpërbërjen e Jugosllavisë, boshnjakët po përbuzeshin si tradicionalistë të prapambetur nga përcaktimi i tyre për t’i takuar me fanatizëm islamit etj.

Pa dyshim, shërbimet e posaçme të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë merreshin me këtë lloj raportimi për të monitoruar përhapjen e ideve dhe informacionit që mund të ndikonte në stabilitetin politik të regjimit. Ato mbikëqyrnin si përmbajtjen e botimeve ashtu edhe ndikimin e mundshëm të këtyre botimeve në opinionin publik, veçanërisht për çështje që lidhen me identitetin kombëtar dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo ishte një mënyrë për të siguruar që narrativa zyrtare e Shqipërisë dhe Kosovës (si njësi përbërëse e Jugosllavisë) të mbetej e kontrolluar dhe e konsoliduar.



Të paharruarit

# MEMENTO PËR AGIM MATON

**Sot në "kallaballëkun" tonë letrar kur krijuesit lindin, promovojnë profilin krijues dhe defilojnë si kërpudhat (shpesh edhe helmuese, të rrallë janë krijuesit letrarë të cilët duhet lexuar, njohur dhe pranuar, si rasti i Agim Matos**

**Nehas SOPAJ**

Një ndër emrat e rrallë dhe të spikatur të letërsisë bashkëkohore shqipe, i shfaqur shumë herët në shtypin shqiptar dhe për shumë dekada i heshtur nga pushteti, i rishfaqur tani në kohën tonë, dhe për t'u shuar përfundimisht këtyre dy viteve të fundit, Agim Mato (1947-2021), paraqet një ndër krijuesit e veçantë të letërsisë shqipe që duhet lexuar, njohur dhe kujtuar me pietet për shumë arsye. Duke qenë një nga krijuesit e rrallë për të cilët tashmë mund të flitet vetëm në aorist (sepse ai nuk është më ndër të gjallët), individualiteti letrar i Agimit sot ndikon për mobilizimin dhe freskimin e jetës letrare të krijuesve shqiptarë gjithandej ku kemi nevojë, sidomos në Shqipërinë e Jugut atje prej nga edhe vjen ai dhe që po vazhdon të frymojë.

Fati e kish dashur që ëndrrat e tij e mëdha të kishin "eklipsuar" pa realizimin e tyre në kohën kur edhe kishin lindur, mu në vllugun e rinisë së tij të hershme, ngjashëm si edhe ëndrrat e shumë e shumë krijuesve të tjerë shqiptarë të kohës të cilat i kish ndrydhur dhe fashitur koha e diktaturës, itinitari letrar i autorit shënon nismën e hovshme shumë herët, në vitin e largët 1969 me librin poetik "Jug", për të vazhduar me librin e dytë "Në pragun e shtëpive tona" në vitin 1974, kur kjo "tërhoqi vëmendjen e organeve të diktaturës", me librin e tij të tretë, hovi i krijuesit u këput, dorëshkrimi i tij u kthye në karton, celulozë. Autori që në kohën tonë mund të radhitet në mesin e emrave më të spikatur të kohës, u fut në radhën e shumë e shumë shkrimtarëve të tjerë, duke u radhitur një me fatin e mynxyrshëm të krijuesve, për të cilët sot flasim për krijues me fate të "uraganeve të ndërprera".

Në vitet e shtyra të moshës, Agim Mato u rishfaq me profilin të cilin e njohim: poet dhe piktor, dhe sidomos organizator të jetës letrare të Sarandës, ku themeloi dhe e udhëhoq për shumë vite manifestimin ndër-kombëtar poetik Trilema Joniane e Jugut, ku mblodhi krijues të ndryshëm të vendit dhe të botës, ku krahas prezantimit bashkë-krijuesve të tjerë, arriti t'i botojë veprat e tija, të vjetra e të reja, e ngjalli jetën kulturore të vendit dhe në vazhdimë për disa vite me radhë, i botoi krijimet e krijuesve pjesëmarrës në manifestimin në fjalë, Trilema poetike joniane. Kështu, pas 30 vjet heshtjeje, poeti Agim Mato u rishfaq para opinionit shqiptar si profil i veçantë, shumë interesant dhe me një individualitet që mund të garojë si një personalitet i kohës sonë. Kështu, pas dy librave të hershëm, autori botoi librin "Buka e fjalëve" dhe brenda vitit 2012, e nxjerr në dritë përmbledhjet tjera "Jashtë eklipsit" dhe "Fundo", ndërsa në vitin 2014 vëllimin "Lundrimet" si dhe "Pluhuri i artë i përjetësive".

Për ne të trojeve jashtë Shqipërisë zyrtare që pak kishim dëgjuar për shumë poetë të profilit si i Agim Matos, krijues të penguar që në zanafillë të shpërthimeve të tyre krijuese,



natyrisht që rinjohje e tyre në fakt është thjesht njohje që sa na ngazëllen, po kaq na dhemb, sepse në kondita tjera, ne kishim njohur plot krijues të fateve të këputura. Varganit të krijuesve martirë, radha e krijuesve me fate të ndërprera, mes të cilëve mund të radhitet edhe Agim Mato, në mesin e shumë krijuesve të cilëve u është përshëndëruar fati krijues, ka edhe krijues të cilët sot janë tmerrsisht të denigruar. Ndër më eklatantët është rasti i Zef Zorbës, një ndër krijuesit që për jetë të tij nuk qe botuar asgjë kaq sa përvijimi i fatit të tij krijues është rekord për Gjinis, sepse vetëm tani pas vdekjes mësojmë për një mjeshtër të poezisë shqipe, kurse poezitë e tij i turpërojnë antologjistët të cilët harrojnë ta prezantojnë në veprat e tyre. Në rastin e Agim Matos, para dy-tre dekadash, them se unë në letrat shqipe kisha dëgjuar dhe lexuar për emrat e Sulejman Matos, Vullnet Matos, por jo edhe të autorit tonë. Miqtë e mi të ndryshëm të Shqipërisë zyrtare, më flisnin për të si krijues të rrallë që, sado i shtyrë për nga moshë, vetëm tani në kohën postkomuniste ka filluar të botojë poezi të një vokacioni që shkruan ndryshe nga të tjerët dhe që do të ishte kënaqësi ta njihje, por unë nuk dija për profilin e tij krijues që nga periudha komuniste. Nuk di se kush prej tyre më kish thënë se ai krijues në një poezi të tijen, madje më përmendte mua, diçka si referencë, dhe kjo gjë natyrisht, s'kish si më linte indolent që të mos mësoja për të se kush ishte ai. Kjo është uvertura e njohjes sime e Agim Matos. Krejt kjo, gjersa një ditë, pashë një ftese në postën time elektronike që ma kish përcjellë ai vetë, duke më ftuar në takimet poetike që i organizonte në Sarandë. Natyrisht

që u emocionova dhe kërkova të kontaktoj me të. Them shumë pak dija për Agimin, mësova se ndër takimet e ndryshme poetike, ndërshqiptare, që i organizonte ai, se mbahehin kryesisht tre ditë, kohë që për ne dashamirës të flaktë të detit, sidomos "bluve të Jugut", na u duken të paktë duke e ditur se ato ditë iknin fluturimthi, kështu që ambienti bregdetar, atmosfera festive dhe sensualiteti i miqësive mes krijuesve që lindnin aty për aty, bënin që njeriu ta harrojë kohën e cila shpejt mund të shndërrohej në ëndërr.

Kisha qenë në takime të ndryshme poetike që mbahen gjithandej në trojet shqiptare, kurse në Shqipëri kisha qenë në Shkodër, Korçë, Elbasan, Durrës e tj. por kjo në Sarandë, o Zot, këto që i përgatiste dhe organizonte Agimi, do të mbahen mend se ato ishin shumë të ngrohta, miqësore dhe me një përkujdesje shumë të madhe ndaj mysafirëve që i kish ftuar, dhe ato nuk harrohen lehtë. Ftesat e tij kanë qenë të rregullta, por për t'u nisur për atje, në Sarandë, e di se me një mik timin u nisëm nga Shkupi për në Selanik, me një paralogaritje kohore prej gjashtë orësh që të arrijmë në mbrëmje, në natën dhe vendin ku hapej festivali dhe e di se kemi arritur mu në çastin e duhur të fundit. Vendimin për nisje e mora ala minut, të thuash, në çastin e fundit, dhe krejt kjo ndodhi pas një bisede të shkurtër me Agimin, duke e njoftuar se a do të ketë kohë për nisje, po kur ai na thau: nisuni menjëherë, unë dhe miku im, Sermet Sulejmani, u nisëm një rrugë mbase më të gjatë se sa rrugës kah Maqedonia, por më të shpejtë rrugës së Selanikut, të cilën miku im e njihje mirë.

Dhe, ky ishte rasti kur unë u njoha

drejtpërdrejt me Agim Maton, krijuesin shtatshkurtër, por të qetë, të urtë dhe shumë miqësor, pastaj me Sarandën dhe me takimet poetike të cilat ai i organizonte në mënyrë pikante, të mrekullueshme të cilat kanë një ëmbëlsi kujtese edhe tani nga larg... Sot në "kallaballëkun" tonë letrar kur krijuesit lindin, promovojnë profilin krijues dhe defilojnë si kërpudhat (shpesh edhe helmuese, kur ics krijuesi mund të mos e meritojë fare atë epitete), të rrallë janë krijuesit letrarë të cilët duhet lexuar, njohur dhe pranuar, si rasti i Agim Matos. Një organizator i cili di t'i mbledhë në një manifestim tre korifejt e poezisë bashkëkohore shqipe, siç janë Ali Podrimja, Xhevair Spahiun dhe Zef Skiro di Maxho, nuk mund të mos jetë mbase jo të nivelin të tyre, por për afërsisht të përafërt si te ata. Nëse veprat e Agim Matos nuk janë të atij niveli (kjo, për shumë lexues mund të jetë vlerësim i pasaktë, subjektiv, për çka lexuesve u jap të drejtë plotësisht), a s' shihet, a s' flet pikërisht ky digresion i imi në hyrje të fjalës sime, se pikërisht ky uragan, po të mos qe ndërprerë, mund të kish rezultuar një gjigant të presupozuar prej krijuesi, i cili mjerisht na mbetet ta kishim pasur në mesin e atij treshi ideal, që e përmendëm më lart. Sa e sa fate talentesh të këputur ka shënuar njerëzimi. Me mija.

Agim Mato po gëzon pëlqimin e vepërës së tij poetike, them unë, për hir të urtësisë së tij krijuese. Njoh dhjetëra korifejt të cilët nuk e kanë atë privilegj admirimi si Agimi, mbase për hir të një rrezatimi brenda tij që na bën ta kujtojmë me pietet. Lavdi vepërës së autorit!

Qasje

# VLERAT QË PO SHUHEN NË LUGINËN E SHKUMBINIT

**Mungesa e informacionit tek të rinjtë për vlera të tilla kaq përfaqësuese të kulturës sonë popullore, shpërfillja e tyre në tekstet shkollore, është gabimi që shumë shpejt do ta paguajmë me harresën e pakorrigjueshme**

**Nga Dr. Skënder KARRIQI**

Kur Prof Ramadan Sokoli shkruante në vitin 1965 për polifoninë shqiptare në studimin me titull "Folklori muzikor shqiptar", dhe me këtë rast ai shënjojte si bartëse të saj edhe Luginën e Shkumbinit, kjo dukuri e lashtë muzikore ishte një realitet i gjallë në këto treva. Po kështu edhe kur Dr. Benjamin Kruta shkruante në vitin 1989 për të njëjtën dukuri, studimin me titull "Polifonia dyzërëshe e Shqipërisë jugore" dhe me këtë rast edhe ky e shënjojte Luginën e Shkumbinit dhe veçanërisht Rajcën, qartësisht si bartëse të kësaj dukurie (të detajuar me emrat përkatës të fshatrave bartës, me emra interpretuesesh dhe moshën e tyre, me të dhëna hapësinore, nuanca, variante e invariante dhe me tituj e shembuj këngësh), ende polifonia, gjatëgjatë kësaj hapësire luginore, vazhdon të ishte një dukuri e gjallë. Njëpër odat e shtëpive fshatare të mobiluara me shije të spikatur popullore ku përftohej ndjesia e butësisë, me aroma lulemale, por edhe me erëza kopshesh e frutash vjeshtore, sidomos në dasma dhe fejesa, këndohej polifonia dyzërëshe e grave. Nusët dhe vashat këngëtare përfshiheshin në një garë të brendshme që i motivonte të interpretonin aq thjeshtë dhe bukur këngën polifonike dyzërëshe para "jurisë" së më të moshuarave, të cilat, duke dhënë me shenja pëlqimin për interpretueset më të mira, nuk i kursenin lëvdatat edhe për të tjerat. Shumë prej këtyre interpretueseve njiheshin ndër krahina si marrëse dhe pritëse me famë të këngës, madje përfaqësonin edhe fshatin apo krahinën në aktivitete lokale, prej nga përzgjidheshin më të mirat, të cilat më tej përfaqësonin rrethin në festivale kombëtare e mbarëkombëtare.

Për fat të keq, të paktën që nga vitet 2000 dhe deri sot, periudhë kohore kjo kur polifonia shqiptare u shpall kryevepër e njerëzimit dhe si e tillë u mor në

mbrojtje nga UNESCO, e gjithashtu Prof. Dr. Vasil Tole, (një ndër përgatitësit e dosjes për konkurrim pranë UNESCO-s), ka shkruar libra të shumtë rreth kësaj dukurie të rrallë muzikore, siç mund të përmendim "Folklori muzikor, (Isopolifonia e Monodia)", "Pse qanë kuajt e Akilit", etj, polifonia dyzërëshe e grave në Luginën e Shkumbinit s'është më veçse pothuajse një dëshmi shkrimore në vepra profesorësh dhe akademikësh. Po kështu në kujtesën e bartëseve të moshuara, kënga polifonike dyzërëshe që këndohej dasmave, sot s'është veçse, pothuajse, një kujtim i largët, (20-30 vjet më parë), i cili do të shuhet bashkë me to për shkak të vdekjes natyrale të tyre. Me shuarjen e tyre Luginës do t'i mungojë jo vetëm zeri polifonik i shpirtit të saj, por edhe kujtimi i këtij zëri. Dhe në këtë rast humbja do të jetë shumë e madhe.

Kjo gjendje rreziku, jo vetëm për polifoninë dyzërëshe në hapësirën që në Rajcë e gjatëgjatë Luginës së Shkumbinit, por edhe në gjithë Toskërinë, padyshim lidhet me ndryshimet që ndodhën në jetën shqiptare, kryesisht në zonat rurale, pas viteve '90-të. Në këtë periudhë rituali i dasmës zhvendoset nga shtëpitë fshatare, në lokalet rurale të shërbimit, përgjatë rrugëve kryesore dhe dytësore apo në qendra fshatrash. Para viteve '90-të rituali i dasmës rregullohej prej kodit përkatës, nëpër odat fshatare (konakët), ku gjindja sistemohej në bazë gjinie (oda e burrave, oda e grave) dhe në intimitetin e farefisit apo më gjerë, miqësisë, këndonin këngë polifonike, në përputhje me momentet e ritualit (nisja e krushqve, ardhja e nuses, mbyllja e dhëndërrit, etj). Rituali i dasmës si i tillë, i mban të gjallë këto këngë. Në situatën e këtij rituali ato jo vetëm krijoheshin, por edhe përsoseshin, shfaqeshin, funksiononin si pëshënjuese të emocioneve të dasmës, ngjarjes më të bukur në jetën e njeriut, Për shkak të zhvendosjes në lo-

kalet rurale rituali i dasmës thjeshtohet gati-gati në një drekë apo darkë të madhe farefisnore ku pjesëmarrësit janë të çliruar prej kodit sipas të cilit duhet të këndonin dhe të kërcenin në raste të tilla. Rëndom në këto dasma me ritual të reduktuar, shërbime të tilla përmushen nga DJ me "programe" klishe, më së shpeshti tallavaje dhe turbofolku, të cilat i dëgjon pothuaj në çdo dasmë. Klishe të tilla, për fat të keq mediokre, kanë bërë që polifonia e gjallë popullore, kënga e dasmës, sidomos polifonia dyzërëshe e grave, në Rajcë dhe gjatëgjatë Luginës së Shkumbinit, por edhe më gjerë akoma, (në tërë Toskërinë), të harrohet. Rrjedhimisht, shpejt apo vonë, po nuk u morën masa, me shuarjen e brezit të parë apo të dytë, që janë ende bartës të saj, edhe ky variant polifonie do të shuhet.

Sot, në biseda me nxënës e studentë, kur bie fjala për polifoninë shqiptare, vihet re se rreth kësaj teme ka mungesë të paturueshme informacioni, gjë që duket sidomos në konceptin e ngushtë për llojshmërinë dhe shtrirjen hapësinore të saj. Ndërsa nuk bëhet fjalë fare për shprehje sado të thjeshta interpretuese të saj prej të rinjve! Për paradoks, kjo gjendje vihet re sot, kur polifonia shqiptare ka afërsisht 12 vjet nën mbrojtjen e UNESCO-s, e shpallur si kryevepër e njerëzimit. Për të rinjtë shqiptarë (dhe jo vetëm për të rinjtë), polifonia është vetëm labe dhe i përket vetëm Labërisë, më saktë, rrethet të Vlorës, Gjirokastrës, dhe Tepelenës. Ndërsa në tekstet e lëndës "Historia e artit" për shkollat e mesme, por edhe për studentët e Akademisë së Arteve, nuk gjen të shkruar as edhe dy rreshta, qoftë sa për ta përmendur polifoninë shqiptare si kryevepër të njerëzimit dhe pjesë të trashëgimisë botërore të mbrojtur nga UNESCO, që nga 25 nëntori i vitit 2005. Mungesa e informacionit tek të rinjtë për vlera të tilla kaq përfaqësuese të kulturës sonë popullore, shpërfillja e tyre në tekstet shkollore, është

gabimi që shumë shpejt do ta paguajmë me harresën e pakorrigjueshme, me shuarjen e traditave më të mira kulturore të popullit tonë. Prandaj lipset sensibilizimi për ta kuptuar rëndësinë e problemit. Në Republikën e Shqipërisë, sigurisht, ka një ligj për kulturën dhe trashëgiminë kulturore të popullit tonë dhe këtij ligji janë të detyruar t'i përmbahen si Ministria e Kulturës, edhe pushteti lokal. Ky i fundit, pas reformës administrative, duhet të këtë më shumë kompetenca dhe të planifikojë më shumë fonde në fushën e kulturës dhe veçanërisht të kulturës popullore, sidomos në aspektin e mbrojtjes dhe promovimit të saj, në mënyrë që në Luginën e Shkumbinit, edhe në trevat e tjera bartëse, të rikthehet, tradita aq e vyer e polifonisë dyzërëshe të grave, por edhe vlera të tjera të rrezikuara. Rikthimi tek traditat e aktiviteteve kulturore popullore në nivele lokale do të ishte hapi i parë për mbrojtjen e pasurive të tilla, siç është polifonia. Në rrethin e Librazhdit, por edhe në rrethe të tjera, është ringjallur tradita e festave zonale. Pikërisht ky impuls duhet të stimulohet, projektohet dhe menaxhohet, ndër të tjera, edhe si një ditë festivi për traditat më të mira të këngës, valles, lojërave popullore, riteve të punës dhe të festave familjare, duhet të projektohet pra si një ditë manifestimi për mbarë kulturën popullore zonale. Padyshim, rol të pazëvendësueshëm në këtë ndërmarrje të gjerë kulturore, do të këtë edhe shkolla, e cila me anë të projekteve lëndore e ndërlëndore, ku theksohet do të vihet edhe në anën praktike interpretative të varianteve polifonike, do t'i kontaktojë nxënësit me një botë tinguish, zërash dhe ritmesh, e cila, edhe pse në shuarje e sipër, ende pulson. Kur në atë botë vlerash që u përket, ata, nxënësit dhe në përgjithësi të rinjtë, do të rigjejnë virtualisht vetveten, pikërisht kjo do të jetë or ae shpëtimin që e duam të gjithë...!



Gjekë Marinaj: "Më mëso si të pëshpërit"

# THYERJA E DHIMBJES DHE E PASIONIT PËRMES POEZISË

**Shpirti i "Më mëso si të pëshpërit" luhet midis pafundësisë padimensionale dhe kompaktësisë. Disa nga poezitë portretizojnë rininë e Marinajt në Shqipëri, ku balada gojore dhe vargjet epike ndikuan në formimin e tij**

**Nga Dr. Skënder KARRIQI**

Vepra e Gjekë Marinaj "Teach Me How to Whisper: Horses and Other Poems" (Më mëso si të pëshpërit: Kuajt dhe poezitë e tjera), bashkë-përkthyer nga autori dhe Frederick Turner (Syracuse University Press, 2023), shënon debutimin në anglisht të një poeti amerikan me origjinë shqiptare, i cili ka marrë çmime të mëdha në mbarë botën dhe ka botuar me dhjetëra libra në shumë gjuhë. Më shumë se tridhjetë vjet duke u marrë me shkrim, koleksioni nënvizon rezonancën e Marinaj nëpër kultura. Risia radikale e poezive buron nga ripërfshirja me traditën. Merrni parasysh se si forma e përforcon erosin e ndërlikuar të kësaj lirike:

Mbrëmja i mbulon sytë sonte  
Dhe thith trupat tanë në të.  
Ne jemi dy shkarravina të dritës,  
Nga të gjitha artet më intime.

Ose ashpërsia dhe butësia e shoqëruar në një homazh për gruan e poetit, një infermiere e ICU që përballet me Covid-19:

Ne do të përdorim mushkëritë e njëri-tjetrit për ventilatorë,  
fryma e dhembshurisë do të qarkullojë ndërmjet...

Strategji të tilla burojnë nga një kozmogoni, ku të gjitha përkushtimet dhe disiplinat kanë barazi. "Duhet të mendoj jo si poet", - guxon të pohojë Marinaj, - "por si shkencëtar - ka një botë për të shpëtuar". Megjithatë, kjo poezi ka mundësi të çmuara.

Një uverturë, "Autoportreti", thërret poetët e Rilindjes elizabetiane dhe angleze, mitologjinë, peizazhet shqiptare, gjeofizikën dhe biologjinë qelizore. Duke i bërë jehonë Uitmanit dhe Nerudës, poeti e përshtat veten me një etikë planetare:

Atmosfera ime është një shtresë e hollë e jetës dhe e vdekjes,  
bërthama e hemisferës së saj mbetet ajo e djersës dhe e gjakut,  
biosfera e saj udhëzon neuronet e mia për t'u lidhur,  
duke ndihmuar litosferën të ruajë fytyrën time nga turpi.

Nuk kam asgjë për të rrëfyer për ligjet e errëta të kaosit,  
Unë i urrej efektet e çdo preludi të pushimit,  
shkatërrimi qoftë edhe i një personi për të mirën e një tjetri.

Shpirti i "Më mëso si të pëshpërit" luhet midis pafundësisë padimensionale dhe kompaktësisë. Disa nga poezitë portretizojnë rininë e Marinajt në Shqipëri, ku balada gojore dhe vargjet epike ndikuan në formimin e tij. "The Lullaby Singers" (Këngëtarët e ninullave) përshkruan në mënyrë surreale sjelljet e fermerëve malësorë:

... Djersa, si një banakiere komike,  
i fikin cigaret. Para se të bashkohen në këngën e shpendëve, gishtat e tyre i kthejnë në grabujë për t'i dhënë tokës një krehër përfundimtar.

Në librin "Një libër dhuratë nga

prindërit e mi", duke kujtuar sesi babai i Marinaj konfiskoi një antologji klasike greke që e shpërqendronte djalin e tij nga shpëtimi i barit nga shiu, poeti i rritur mendon për besnikëri të qëndrueshme. Duke nderuar rastin e tij dhe të familjes, Marinaj fiton një vend në prejardhjen letrare:

Unë e bleva librin pa lejen e tij,  
atë libër që unë e shfryj tani gjatë gjithë ditëve të tyre,  
sikur të shihja aty gjithë dhimbjet dhe pasionin e tyre,  
dy mrekulli, njësoj, që ende mahnitin.

"Më mëso si të pëshpërit" vendos rrënjët e pjekura brenda qytetërimit më të madh. Duke dhënë dëshmi lineare të të mësuarit, Marinaj distilon edhe thelbin e tij, duke praktikuar një kriptografi metafizike, imagjinare që hyrja e bashkë-përkthyesit Frederick Turner, e krahason me krijimin e ikonave:

Homeri deshifroi abstraksionet e filozofëve të vjetër...  
Ai ripërcaktoi kodet gojore,  
duke tjerë baltën e tyre të madhe të leshit në dy gishta midis shkronjës I dhe numrit 0.

Poezitë si "Haleluja" dhe "Në tragetin e Akeronit" të përhumbur nga imigracioni shpalosin ikonografinë qiellore dhe sketerrën, me "duart e të urtëve një piramidë që drejtojnë drejt Jupiterit" dhe demonët që "projektojnë të ardhmen / qytetërimin mbi tokë".


Odet e frymëzuara nga lidhjet ndër-

kombëtare zgjerojnë njohuritë dhe ndjeshmërinë e koleksionit. Pikat kryesore përfshijnë monologun e "Nilit Blu" ("në barkun tim unë rrit peshq dhe krokodilë") dhe një raport nga Gjiri Ha Long i Vietnamit ("Një guaskë e ngrohtë magjike për tokën për të inkubuar thelbin e saj"). Në mbylljen e "Shtresave të humbura të lëkurës së Vyasës", një epik i ndërgjegjshëm që përfaqëson majën e etnografisë së librit, muza e poetit gjen harmoni me kozmosin fleksibël të hinduizmit:

I lutem Vishnu-s për dhuratën e tij të asaj pjese të energjisë së diellit që ai e kishte ruajtur për mua të më jepte dritë,  
Dhe me përlësi ofroj përkufizimin e nënës sime:  
hapësira është një organizëm i hapur me origjinë organike.

Rregullimi i librit "Më mëso si të pëshpërit" është tematik dhe jo kronologjik. Në seksionin e saj të tërthortë të orientimeve, stilet e kundërta mbështesin njëri-tjetrin dhe i flasin lexuesit ndryshe - nganjëherë drejtpërdrejt, ndonjëherë në "metafora hermetike", logjika e të cilave rezultojnë thellë pas leximit të kujdesshëm. Secila prej mënyrave të ndërthurura të Marinaj është bindëse, qoftë duke rigjallëruar "kuajt" e veshur mirë apo duke hipur në transcendencë mes ndryshimeve të modernitetit. Këtu e gjithë poetika lëviz zemrën dhe mendjen. (Marrë nga: Worldliteraturetoday.org)

**Solli në shqip: Fitim NUHIU**



Në sytë e një studiuesi

# ARTI DRITHËRUJES DHE I MREKULLUESHËM I MIRA MEKSIT

(Rreth librit monografik «Venera del nga deti» i Shpendi Topollaj)

**Agim BAJRAMI**

Të shkruash për krijimtarinë e Mira Meksit, kësaj përkthyesë dhe shkrimtare me një profil të qartë dhe të dallueshëm krijues në letrat tona, është padyshim një kënaqësi, por edhe një punë e vështirë. Është kënaqësi sepse të jepet rasti të depërtosh në procesin krijues të autores dhe stilistikën e saj të spikatur dhe të veçantë, të njohësh dhjetëra bota personazhesh, njëri me interesante se tjetri, si Amazonat, Frosinat dhe Teutën e Ilirisë vendosur në një klimë dhe ambiente tipike shqiptare, është punë e vështirë, sepse të analizosh një individualitet letrar të spikatur si ajo, me veçoritë e së cilës janë marrë dhe vazhdojnë të merren penat më të mira të kritikës dhe studimeve tona. Si një autore që e ka tejkaluar rrëfimin tradicional sipas mendimit të kritikës, romanet e saj krahas forcës pasqyruese, krijojnë për lexuesit tanë një befasi interpretimesh dhe një klimë të re leximi. Ndoshta janë këto veçanti që e kanë shtyrë autorin Shpend Topollaj, t'i futej me zell librit monografik «Venera del nga deti» me analiza kritike dhe ese kushtuar krijimtarisë në rrjedhë të saj. Duke qenë një ndjekës i vëmendshëm i prurjeve të shpeshta letrare të kësaj autoreje, Topollaj evidenton me hollësi disa nga tiparet esenciale të kësaj krijimtarisë si gjuhën e veçantë të shenjave, enigmat, misterin dhe të fshehtat e pafund të prozës së saj, të cilat kjo autore po i stilizon dhe i përsos nga vepra në veprë.

Mira Meksin mund të konsiderojmë si një dhuratë të vyer për letërsinë tonë, thotë me plot gojën autori, ngaqë ajo nuk hyri në oborrin tonë letrar me pretendimin për të shtuar në të ndonjë pemë apo lule, por për ta pasuruar atë me freskinë e saj krijuese, me koncepte të reja dhe me frymë bashkëkohësie. Parametrat e larta artistike që ju përmbahet ajo në krijimtari dhe një stilistikë novatore, e kanë bërë lexuesin të kthejë herë pas here vëmendjen nga ajo, ndërsa kritikën pesimiste të ndryshojë mendimin e gabuar për gjoja stanjacionin e letërsisë sonë në këto dekada. Nisur nga kjo, autori i përmbahet bindjes se çdo libër i saj është një enciklopedi më vete, ku nuk e kupton dot se ku mbaron realiteti dhe ku fillon fantazia, duke e bërë veprën e saj një vepër të gjithëkohshme. Për raportet mes fantazisë dhe realitetit, ai ndalet gjatë në disa nga romanet e saj, veçanërisht në romanin «Diktatori në kryq», një roman me një strukturë dhe kompozim mjaft dinamik, ngjarjet e të cilit edhe pse zhvillohen në kohën e diktaturës, në një fshat karakteristik të Shqipërisë, kanë një jehonë dhe rezonancë universal. Duke analizuar personazhet e këtij romani, autorit i bën përshtypje saktësia matematikore në morinë e veprimeve apo fjalëve të njerëzve, psikologjitë dhe sensi i gjallë i realitetit, si dhe sfondet kohore në të cilin autorja vendos personazhe të famshëm si Apiani, Pouqueville, Von Hahni, Stalini, Xha Mihali etj. Pësja e prozës së kësaj autoreje shtohet edhe më shumë nga trajtimi i suksesshëm i temës së lashtësisë dhe gjuhës sonë amtare, të cilat për një komb i rrezikuar si yni, kanë qenë dhe mbeten më të çmuar se besimi në Zot. Shpend Topollaj, si një vëzhgues i thellë dhe i palodhur i letërsisë sonë, e tërheqin vazhdimisht autorët që

tentojnë të sjellin risi në krijimi, ose të ashtuquajturin trajtim tjetër-lloj, që konsiston te zbulimi i së padukshmes dhe evidentimin e përroit psikik në botën e brendshme të personazheve të tyre. Edhe pse ky është një proces që do kohë dhe shumë talent, autorja vazhdon të këmbëngulë dhe të japi rezultate të kënaqshme. Paralelet që heq ajo mes heroit të saj real, Ismail Kadare dhe shkrimtarit të shquar rus, Boris Pasternakun, përthyerjet dhe kthesat e mëdha që ndodhin në ndërgjegjen e tyre, të shqetësuar, në çastin kur mësojnë të vërtetat e mëdha, janë më shumë se epike. Shpendi Topollaj është një studiues me një kulturë të gjerë letrare dhe historike, dhe këtë erudicion ka ditur ta vendosë në shërbim të studimeve të tij kritike. Është rast i rrallë, për të mos thënë e pamundur, që gjatë interpretimit dhe zbërthimit të një veprë letrare dhe artistike, të mos e kundrojnë atë në një shumësi planesh dhe mos t'i ilustrojë pohimet e tij me postulate filozofesh, shkrimtarësh apo njerëzish të shquar të kohëve. Mbështetur mbi to, ai sikur gjen më shumë hapësirë për t'u shprehur, por edhe me shumë siguri.

Kjo veçori e kritikës së tij spikat edhe gjatë interpretimit të librit tjetër të autores «Mallkimi i princeshave të Ilirisë», i cili, sipas opinionit të autorit, mbush një boshllëk të madh në romanin tonë me këtë temë. Është një vepër që depërton përtejshkujve, që i ka mbuluar si mallkim mjegulla e mospasjes sa duhet të dokumenteve autentike, apo

pluhurit të pamëshirshëm të harresës. Me shkrimin e kësaj veprë, Mira Meksi ka vënë në lëvizje trillin, fantazinë dhe imagjinatën e vet të jashtëzakonshme. Dhe, duke mos u mjaftuar me kaq, autorja si askush para saj, ka ditur t'iu hedh ngjarjeve dhe personazheve të saj tunikën e purpurt të mitologjisë. Është entuziazmuës fakti i shndërrimit të anës historike në anë artistike guximi për të shkruar larg në kohë, si dhe arti me të cilën është shkruar kjo vepër. Kjo e ka shtyrë autorin të bëjë edhe pohimin e guximshëm, se nuk ka në gjithë historinë e letërsisë sonë një rast tjetër identik, që si me magji ta largojë lexuesin nga realiteti ku vegjeton dhe ta fusë atë në një botë që edhe pse aluzive t'i duket e vërtetë, sikur ka jetuar dhe vazhdon të jetojë edhe vetë në të. Për të shkruar një libër të tillë, supozon ai, autores Mira Meksi i është dashur të shfletojë një bibliotekë të tërë, të futej në kohë dhe hapësirë të panjohur, të fliste me njerëzit dhe besëtytnitë, të alternonte sjelljet e njerëzve me ato të perëndive të të cilat ju faleshin, si dhe të pikturonte sfondin ku zhvilloheshin ambicet, dëshirat dhe synimet e heroinës kryesore të kësaj veprë, Teutës së Ilirisë, pas vdekjes së të shoqit Agronit. Autorja e ka vizatuar mbretëreshën si një njeri prej mishi dhe gjaku portretin, duke nënvizuar ndërkaq edhe bindjen e paepur të saj, se ajo kishte lindur për të bërë vepra të mëdha. Depërtimi nën lëkurën e këtij personazhi kaq interesant, por dhe kaq të koklavitur,

natyrisht që është një punë e vështirë, të cilat Mira ka ditur ta kalojë me sukses. Duke shfletuar ditë për ditë në tryezën e tij të punës listën e gjatë të veprave të kësaj autoreje të spikatur, Shpendin e tërheq së tepërmi aftësia e saj si përsa i përket përzgjedhjes së temave, ashtu edhe kompozimet e tyre interesante brenda logjikës së ngjarjeve, fantazia e shpenguar në vizatimin e personazheve, bukuria e frazës, por, mbi të gjitha, kultura e gjerë e saj në fushën e historisë dhe miteve. Reflektim të kësaj kulture ndeshen më së miri në romanin «Puthja e Amazonës», një vepër kjo që shënon një kulmi artistik në artin e saj të prozës së gjatë. Është një krijim që e ka shndërruar këtë autore në apologjete të botës së grave në kohë. Për ta bërë më të spikatur këtë pohim, autori gjen rast ta karakterizojë atë me fjalët që Tolstoi i madh kishte thënë dikur për shkrimtarin e madh francez, Gi de Mopasan. Zor të gjesh një shkrimtar tjetër, që të ketë pohuar aq sinqerisht se të gjitha të mirat që ka jeta dhe i gjithë kuptimi i tyre të përqendrohet te gruaja dhe dashuria për të. Në këtë roman nënvizon studiuesi, autorja ka bashkuar në një historitë e dy vajzave, që ndonëse në dukje nuk i bashkon asgjë (largësia në kohë dhe diferenca mes fantazisë dhe së vërtetës), plotësojnë më së miri njëra-tjetrën. Ndaj nuk befasohe, thotë autori kur «mes mjegullnajave të pafundme dhe botëve të reja që i parakalonin, syri i amazonës pikasi krijesën që i lutej për ndihmë. E vështroi thellë dhe e njohu. Ajo ishte shëmbëlltyra e saj, kohërave të pafundme që pritej të vinin. Ishte krijesa që e kishte pranuar dashurinë pa iu nënshtruar. Gaukia ndjeu se ortekët e pambarimtë, që do të rrokulliseshin mbi botën e saj, të puqeshin në një çast vetëtime. Edhe në këtë vepër autori vëren kujdesin e Mirës, që çdo imtësi të vërë në funksion të idesë së saj, duke i mëshuar fort mesazhit se dashuria është zjarr që shkrumbon gjithçka, është përbindësh që kërkon çdo ditë të ushqehet me gjakun dhe mishin e dashnorëve, që magjeps, shkel mbi çdo gjë dhe çdo kund, që rreket ta ndalë në rrugën e saj. Autori i mëshon mendimit që vepra me një forcë të tillë artistike dhe me subjekte kaq intrigues janë të vyera dhe të gjithëkohshme, ndaj duhet të vihen sa më shpejt në duart e lexuesit. Të njëjtën gjykim ka ai edhe për romanet e tjerë «Frosina e Janines», «Kutia e Agatha Kristie», kushtuar anës njerëzore të patriotit të madh atdhetar Mid'hat Frashëri, Parisi vret, «Buzëqeshja e fundit e Beatrices», «Dashuri e fajshme» (novelë) etj. Libri «Venera del nga deti» ashtu sikurse të gjithë romanet e Mira Meksit dallojnë për një larmi metaforash, shumësi subjektesh dhe ngjarjesh të larmishme, ata i bashkon njëri me tjetrin thënia lapidar e Virgjilit «Dashuria fiton mbi gjithçka» dhe kjo i shpjegon të gjitha. Portreti i Mira Meksit nuk mund të merret kurrë i veçuar nga puna e saj e gjatë si përkthyesë e suksesshme e disa prej korifejve botërorë të letrave, si Gabriel Garcia Marquez, Pablo Neruda, Vargas Llosa, Jorge Luis Borges, Ernesto Sabato, Margarret Duras etj. Ndoshta është edhe hija e madhësisë së tyre që e bën këtë portret t'i ngjajë me plot kuptimin e fjalës, një Venere moderne në letërsinë tonë të çliruar nga censura dhe totalitarizmi i dikurshëm.



## VENERA DEL NGA DETI

Mbi krijimtarinë e Mira Meksit

Shpendi Hulësi Topollaj

Recension

# UNIVERSI POETIK SI KRONIKË MBIJETESE

**(Mustafë Xhemaili, POEZI, botoi Shtëpia botuese DRINI, Ferizaj, 2024)****Zyrafete SHALA**

Në brezin e krijuesve, emrat e të cilëve filluan të bëhen të njohur gjatë fund-viteve '70 dhe fillim-viteve '80 të shekullit të kaluar, për herë të parë ishin edhe disa poetë ferizajas. Krijimet e tyre fillimisht u shfaqën në shtypin e kohës, për t'u botuar më pas edhe si vëllime poetike të veçanta të kolanës Plejada të Ndërmarrjes Botuese Rilindja në Prishtinë. Më i hershmi nga këta poetë, pa dyshim, është Mustafë Xhemaili, i cili tani, në 70 vjetorin e lindjes, vjen para lexuesve me veprën POEZI që në fakt është përmbledhje e të gjitha vëllimeve poetike të tij të botuara ndër vite. Si e tillë, kjo përmbledhje na ofron një udhëtim të plotë nëpër opusin letrar të Xhemailit dhe është një mundësie mirë për të rishikuar momentet që kanë përcaktuar trashëgiminë e tij poetike, gjithashtu, edhe për të ndjekur procesin e evoluimit dhe të pjekurisë së tij si krijues. Ky koleksion voluminoz e gjithëpërfshirës, që vjen si dëshmi e karrierës së pasur letrare dhe qëndrueshmërisë së zërit të tij në kuadër të letërsisë bashkëkohore shqipe, përfshin pesë vëllime poetike, të botuara brenda një harku kohor prej tri dekadash: Netëve të verës (Rilindja, Prishtinë, 1982), Fusha e plagosur (Naim Frashëri, Tiranë, 1993), Sëmundjet e botës (Dukagjini, Pejë, 2001), Dorëshkrimi nga dheu (Rozafa, Prishtinë, 2003) dhe Për me dekë bukur (Rozafa, Prishtinë, 2008). Vetë distanca kohore mes botimeve (me theks të veçantë të dy librat e parë) dhe ndryshimet që pësojnë titujt e veprave, për nga ngarkesa emotive e kuptimore, sikur i ofrojnë lexuesit një njoftim paraprak të rrugëtimit të autorit nëpër shtigjet e poezisë. Të rikthyera kështu të lexuesit, të shkruara në një botim, duke ruajtur imazhin me të cilin u shfaqën dekada më parë, por duke sjellë edhe gjurmë të censurës së pushtetit armik, poezitë e Mustafë Xhemailit e nisin jetën e dytë në kohë e rrethana të reja, kur më shumë se kurrë në është e domosdoshme kujtesa / dëshmia që ato e ndryjnë në fjalë e varg. Meqë poezia është vokacioni kryesor, por jo edhe i vetmi i Mustafë Xhemailit, ky projekt mbase nuk do të përfundojë këtu, por do të zgjerohet doemos edhe në botime të tjera, për të përfshirë shkrime kritike e publicistike, që zënë vend të rëndësishëm në veprimtarinë e tij krijuese.

**Ndërthurja simbiotike e jetës dhe krijimtarisë**

Kur flitet për krijimtarinë letrare të Mustafë Xhemailit, doemos duhet ndalur edhe në veçantitë e trajektores jetësore të tij, sepse ekziston një lidhje simbiotike mes këtyre dy komponentëve, e cila, sikur e pamundëson qasjen ndaj një rreze me tendencë të anashkalimit të tjetër; ngase në raste të tilla gjithmonë do të kemi një diskurs gjysmak, të mangët dhe shumë larg thelbësorës. Mustafa i takon atij brezi që mbase u rritën me shumë mungesa e vështirësi materiale, por që ishin shumë të pasur shpirtërisht dhe tërhiqeshin drejt zbërthimit të mistereve të jetës, ndaj: zhyteshim thellë në çuditë e kaltëra...//aty ku rrinim vinte era libër / dhe aromë mollëve, thotë poeti. Ishin pikërisht librat, krahas natyrës së bukur të vendlindjes, që kultivuan ndjenjën e atdhedashurisë të poeti dhe që formësuan një shqisë të re për të perceptuar çdo dhimbje të kombit, sado e mbytur qoftë ajo. Për koïncidencë, edhe botimi i veprës së parë, që për çdo poet paraqet një moment tejet të rëndësishëm jetësor, për Mustafë Xhemailin korrespondon me një kohë të pakohë, me një kohë kur populli i tij sapo kishte nisur rrugëtimin nëpër kalvarin e ri, drejt përmbushjes së ëndrrës, prandaj

MUSTAFË XHEMAILI

POEZI



BOTIMET DRINI

edhe poezive të vëllimit Netëve të verës para se të mbërrinin te lexuesi, iu desh të kalonin nëpër lloj-lloj filtrash, ideologjikë e shovinistë, për të parë dritën e botimit. Megjithatë, përkundër zellit të censurës, përkundër largimit të disa poezive, jo gjithçka arriti të deshifrohej dhe jo çdo figurë arriti të interpretohej; prandaj qysh në vëllimin e parë Xhemaili arriti t'i ofrojë lexuesit kodet e preokupimeve jetike të tij. Ai u shfaq në skenën letrare të kohës me një zë të pjekur dhe të artikulluar poetik, me një gjuhë sa të çrëndomtësuar e të kodifikuar, po aq edhe të afërt e plot ndjeshmëri. Preokupimi i poetit me fatin e atdheut e kombit, nuk shfaqet vetëm si shqetësim poetik, por edhe si angazhim jetësor, gjë që e determinon në njëfarë mënyre rrjedhën e jetës së tij. I përndjekur nga pushteti serb, Xhemaili u detyrua ta braktisë vendlindjen dhe qysh në fillim të karrierës së tij letrare u kthye në një poet të anatemuar e të mohuar. Dhembjen që ish-kakton kjo kthesë jetësore e gjejmë të skalitur në poezitë e botuara pas një dekade, në vëllimin Fusha e plagosur, ku qysh në poezinë e parë, programatike, jepen përmasat e dhembjes dhe vetmisë së subjektit lirik: Hipi mbi majën e Monblanit dhe bërtas në kupë të qiellit nëpër natë/ Askush nuk e kthen kokën për të më prekur dhembjen / Unë albanais i zemrës së Ballkanit, i thellësive mitologjike / I pellgut të madh të mendimit dhe i hapësirave ilirologjike/ Majë Alpeve, majë Kullës së Efelit, majë Kullës së Pizës / Majë Statujës së Lirisë, majë Babilonit e majë dreqit e të birit /

këlthas, bërtas, vritem, gjakosem... fuqia e këtyre vargjeve, të ngjizura nga vuajtja sfilatëse e njeriut të larguar padrejtësisht nga substrati i natyrshëm i tij, jo vetëm që mbërrin pa asnjë barrierë deri te lexuesi, por bart në vete edhe tërë atmosferën që e nxisin atë gjendje të subjektit.

**Motivet – spektër universal i shqetësimeve njerëzore**

Megjithatë, përveç atdhedashurisë, gjeografia krijuese e Xhemailit përfshin pafundësisht tema e motive, qoftë nga ato që i stimulon realiteti objektiv e që ngrihen si refleksione ndaj jetës, qoftë të natyrave të tjera, nga ato që sintetizohen në honet më të thella të unit poetik e që synojnë t'i shndërrojnë në trajta poetike trazimet e hovshme shpirtërore. Gjithsesi, një vend të rëndësishëm këtu zë edhe tema e dashurisë, që nis si trazim njomështak rinor, por që nga njëri vëllim në tjetrin merr përmasat e një force sublime; nga një pasion kalimtar shndërrohet në trajtën e një udhëtimi të përjetshëm, që përshkon çdo aspekt të qenësisë, duke formësuar kështu perspektivat jetësore dhe duke ofruar një ndjenjë të plotësisë së subjektit lirik. Vijnë pastaj një varg motiveve të tjera si motivi i fëmijërisë kur bota shihej e turbullt në globin e vjetër të shkollës; vdekja e babait që i preu në mes përqaftimit dhe jetërat; sëmundjet e botës që i vyshkin lulet e zeza; kujtimi i mikut – poetit që vritet çdo ditë nga pak, për të lindur një ndjenjë, një klithmë njerëzore; refugjati në vigjilje

të shekullit të ri – Golgothë moderne me përmbajtje të vjetër... dhe çka jo tjetër, që nga Thoti i lashtë e deri te dhembja në erë kozmike. Gjerësia tematike që e karakterizon poezinë e Mustafë Xhemailit është një nga cilësitë që është veçuar nga kritika letrare qysh herët, krahas autenticitetit të sistemit figurativ, fuqisë asimiluese të ndikimit, lirizmit të theksuar, afinitetit në përzgjedhjen e mjeteve shprehëse, qartësisë poetike, mendimit të konkretizuar e cilësi të tjera që e krijojnë origjinalitetin krijues së Xhemailit. Në shkrimet e shumta kritike që e kanë përcjellë poezinë e tij, është vënë në dukje edhe aftësia e Xhemailit në harmonizimin e elementeve në dukje kontradiktore – të tilla si diskrecioni në shprehje krahas imazheve të gjalla e konkrete. Ndaj, ky ekuilibër, sipas kritikës, krijon një poezi që nuk është vetëm vizualisht e qartë, por edhe emocionalisht bindëse, ku bashkohet e kaluara me të tashmen dhe intima me socialen, që si rrjedhojë ka një përvojë poetike të pasur, të shtresuar, që rezonon në nivele të shumëfishta.

Përgjegjësia ndaj fjalës së shkruar ka qenë një parim udhëheqës përgjatë gjithë udhëtimit poetik të Mustafa Xhemailit, rrugëtim ky që shtrihet nga vëllimi i tij i parë e deri te veprat e tij më të fundit. Që në fillim, Xhemaili ka qenë thellësisht i vetëdijshëm se: Asgjë nuk është tortura fizike sa tortura për krijimin e një vargu, prandaj i është qasur mjeshhtërisë së tij me një rigorozitet të disiplinuar që duket në çdo varg që ka shkruar. Përkushtimi i tij ndaj krijimit, ndaj përzgjedhjes dhe përdorimit të kujdesshëm të gjuhës, pasqyron një respekt të thellë për poezinë si formë arti dhe si mjet shprehjeje. Vargjet e tij, pavarësisht nga periudha kur janë krijuar apo rrethanat që i kanë paraprirë lindjes së tyre, janë punuar gjithnjë me përkushtim, me përpikëri dhe me pedantëri, të tillë çfarë e kultivojnë vetëm ata që artin nuk e shohin thjesht si një medium komunikimi, pos si pjesë thelbësore të jetës së tyre, që lindin dhe frymojnë me te.

**Rezistenca e shpirtit krijues e gdhendur në varg**

Ashtu siç u bën vend brenda universit të tij poetik të gjitha motiveve që kanë preokupuar njeriun tonë, Xhemaili i kushton vëmendje edhe çdo detaji poetik, çdo stileme, çdo figure, çdo ngjyrimi stilistik për të transponuar sa më denjësisht në art shqetësimet e tij dhe për të qenë i sigurt se çdo objekt poetik është përcaktuar me kujdes dhe është i rrethuar nga ide plotësuese që e rrisin ndikimin e tij të përgjithshëm. Kjo lidhje e brendshme me zanatin e tij i mundëson të krijojë një univers poetik që është i gjerë dhe gjithëpërfshirës, një univers që strehon spektrin e plotë të shqetësimeve njerëzore. Qartësia e shprehjes, si karakteristikë dalluese e poezisë së tij, nuk e zbeh thellësinë e mendimeve; përkundrazi, e rrit aftësinë e lexuesit për t'u lidhur me emocionet dhe idetë e thella që pluskojnë nëpër vargje. Pra, i mundëson komunikimin efektiv me lexuesin duke ruajtur një ekuilibër të ndjeshëm midis kompleksitetit dhe lexueshmërisë. Si e tillë, vepra e Xhemailit është një kontribut jetik për poezinë e sotme shqipe; te kjo poezi përtej bukurisë së shprehjes poetike qëndron një rrëfim më i thellë – një kronikë mbijetese. Poezia e tij kap qëndrueshmërinë e një kulture që ka duruar sprovat e shtypjes, pushtimit dhe mohimit, prandaj vargjet e Mustafë Xhemailit përveç si krijime artistike, na ofrohen edhe si dëshmi e rezistencës së një populli, dëshmi e triumfit të shpirtit krijues edhe kur kjo duket praktikisht e pamundur.

Qasje

# KONSTITUTIVJA POETIKE E NJË LIBRI

(Arif Molliqi, "Im atë të shtunave më blinte këpucë llastiku", "Armagedoni", Prishtinë, 2021)

Sadik KRASNIQI

Arif Molliqi është shkrimtar që shkruan poezi, tregim, roman, dramë, kritikë si dhe monografi shkencore dhe publicistikë. Shumëllojshmërisë shkrimore ky krijues i shton edhe atë sasiore, tashmë prej njëzet e dy librave.

Botuesi i librave të këtij autori, Berat Dakaj, gjatë shqyrtimit të veprave të tij, me të drejtë konstaton se Arif Molliqi emocionet vazhdon t'i shkrijë e t'i shtrijë në poezi. Lexuesi permanent i poezisë së këtij autori lehtë do të vërejë se ky libër është ndër librat më të mirë. Epitetin, ndër më të mirët, ky libër e merr në saje të konstitutivës poetike që përmban. Arif Molliqi ka arritur që me një koshiençë të lartë kreative, motive, tema, ngjarje, ndodhi, fenomene, fiksion, ëndërrime, imazhe, mirazhe, kujtime t'i shkruajë përmes strukturës vargore tejet të kujdesshme dhe me durim urtësie. Vargjet e tij kanë një ritëm përafërsisht konstant. Po ashtu, figuracioni poetik është aplikuar me një masë të përmatshme si prej klepsidre. Duke u nisur nga vetë pamja e kopertinave të këtij libri, të imponohet varianti xhojsian i përimitësuar në përfaqësim të semantikës e semiotikës së lëndës lirike brenda tij. Kopertina është dizajnuar estetikisht e metaforikisht. Smokingu i zi me këmbë të bardhë me flutur të zezë e me faculetën e bardhë në xhep është një e veshur solemne mbi të cilën është gravuar titulli i bardhë, që përmban një kuptim emotiviteti autorial. Vizualja dhe përmbajtja e titullit në kopertinë është një kontrast i bukur metaforik me një nuancë ironie, e që na shërben deri-diku si çelës për kodin përmbajtësor dhe figurativ të librit. Ligjërimi poetik i librit është strukturuar në ciklet: "Im atë të shtunave më blinte këpucë llastiku", "Enciklopedi familjare", "Dielli prej llamarine", "Shumë zhurmë për pak liri", "Dashuri autodidakte" si dhe "Arti i lehjes". Kapitujve u paraprin poezia "Përrallë e verdhë". "Përralla e verdhë" është një prelude poetik që dëshmon një lëvizje, e që kjo lëvizje është një intencialitet dhe esencialitet si frymëzim dhe ekzistencë e genes lirike:

tash e kuptova ç'domethënë nata

pa asnjë yll në qiell

lehtë mund të zë pritë

e liga e fshehur brenda njeriut

(fq.5)

Pra permanentja e lëvizjes si qenie e amshueshme i kalon përmasat e realitetit deri në përrallën e verdhë. Kjo poezi është njëherësh një transcendencë filozofike. Kapitulli i parë "Im atë të shtunave më blinte këpucë llastiku", titull ky që emëron librin, vjen nga poezia ndër më të bukurat e këtij cikli. Poezia në fjalë, për kah dendësia kuptimore dhe figurative, mund të konsiderohet një poemth poetik. Kjo poezi antologjike është poezi sekuenca, e proceduar me vargun e bardhë dhe e ndarë në dy pjesë. Motivet e forta gjithnjë nxjerrin poezi të bukura, siç është kjo poezi. Dy kryetemat iternale të artit - tanatosi e erosi - ndërthejnë bukurinë me anë të një gërshetimi të fenomeneve jetësore përmes figurës së babait që përkujtohet ndjeshëm dhe përmasë. Përmes imagjinatës poeti ndërthur vdekjen me jetën, realitetin me ëndërrën, gëzimin me vuajtjen, dashurinë me urretjen, shpresën me dëshpërimin. Heroi lirik në këtë poezi sa është në realitet, në të njëjtën kohë është në ëndërr e fanitje. Kthimi i tij në vendlindje është imazh real dhe njëkohësisht mirazh: Brenda kornizës së shtëpisë një ngjyrë të errët



përtej një sfond kulla, muret, dyert, pemët  
zogjtë kishin shpërndarë disa njolla gjaku  
figurën time të harruar e gjej në dhomën  
mbi shtrat

aty është im atë

dritë i pastë shpirti

që kishte vdekur atë sene kur ra lia e  
madhe

(fq. 14)

Në këtë pasazh të bukur artistik, përveç realitetit si kthimi në shtëpi, hasim edhe elementin e kujtesës dhe ëndrës me njollat e gjakut të zogjve si simbol arketip i onirikës si prishje e ëndrës. Në këtë poezi evokuese përshkruhet me sens tej sensual elementi erotik, përmes gruas gjysmënuado, gjetje që freskon atmosferën e zymtë të situatës së heroit lirik. Pjesa e dytë e kësaj poezie është krejtësisht analepsë për kohën e fëmijërisë, gëzimi dhe pikëllimi i përjetuar thellë nga shpirti i ndjeshëm i një fëmije jetim. Kjo poezi e veçantë patjetër ta kujton fotografinë e famshme të Gerald Waller "Fëmija që i lumturohet këpucëve të reja", në të cilën shihet vocërraku jetim austriak gjashtëvjeçar Hans

Werfel, duke i përqafuar një palë këpucë të reja dhuruar nga misionarët e Kryqit të Kuq Amerikan. Përderisa cikli i parë është më personal, pra pasqyrim poetik i përbrendësisë së subjektit lirik, cikli i dytë "Enciklopedi familjare" dominohet me përkushtime lirike të të afërmeve familjarë, që zgjerohet në atë njerëzor. Poezitë "Nëna ime, heroina ime", "Kur e varrosëm babën", "Kur mungon vëllai i madh" dhe "Një vdekje në pranverë" janë poezi përkushtimore me nota nostalgjike dhe elegjiake kushtuar më të dashurve.

Shndritjen e nurit të nënës poeti e shpreh me një ngrohtësi shpirtërore:

mollën që e ruante në arkën e nusërisë

e ndante në shtatë pjesë

e ndante në shtatë pjesë

në fytyrën e saj magjike

herë- herë i fluturonte gëzimi

kur na numëronte të shtatë fëmijëve

nëna ime

heroina ime

(fq. 23)

Në këtë ndarje me motive funebre nuk

kemi vetëm vdekjen e të afërmeve, por edhe vdekjen e fenomeneve dhe dukurive që na rrethojnë, madje edhe vdekjen e vet vlerës njerëzore. "Dielli prej llamarine" është cikli më me shumë poezi i librit të Arif Molliqit. Ky cikël me 42 poezi mund të konsiderohet si libër në vete nga llojshmëria tematike e motivore, por edhe nga dendësia dhe llojshmëria figurative.

Poezia "Shah me të vdekurit" është një tërësi metaforike e nuancuar me absurdin që përmes Atlantidës si simbol i bukurisë së humbur në enigmë dhe pamundësisë së gjetjes, vjen deri te një logjikë absurde po estetikisht në nivel. Poeti thekson për detarët:

u ka mbetur vetëm të zhyten në ujë

t'i numërojnë plagët

të luajnë shah me të vdekurit

(fq. 45)

Në këtë cikël me tematikë të gjerë vjen në shprehje e tërë mjeshtëria e shprehjes poetike të autorit. Sipas teoricienëve të poetikës, çdo libër i mirë poetik duhet të ketë : figurat e diksionit, figurat e fjalës ose tropet, figurat e konstruksionit, figurat e mendimit. Përpos të parave që janë tipare të vargjeve me strukturë tradicionale, janë të pakta tek Arifi, në saje të vargut të lirë, të tjerat i hasim përgjatë gjithë poetikës së këtij libri. Kjo poetikë ngrehet përmes figurave, si metafora, metonimia, alegoria, oksimoroni, personifikimi si dhe figura të tjera me të cilat krijon situata absurde, abstrakte, inversione të shoqëruara shpeshherë me një ironi fine.

Arif Molliqi e krijon bukur figurën e konstruksionit: (sipas M. Solarit)

do të duhej t'u vinte turp

qenit dhe maces

kur e imitonin njeriun

ashtu krejt cullak para publikut

(fq. 73)

Pra ky konstruksion figurativ si inversion logjik shoqërohet me ironi si figurë, që Arifi e ka për qejf dhe që e shtron gjatë tërë ligjërimin të tij poetik. Në këtë cikël zënë vend edhe dhjetë poezi të një ekskursioni brenda dhjetë ditëve, ku heroit lirik reflekton në një ambient detar. Andaj edhe rekuizitat e këtyre poezive janë nga fauna detare që në raport me poetin, ambientin dhe njerëzit përreth, shkaktajnë imazhe të bukura. Peshku në këto poezi merr trajtën e një metafore të zgjeruar:

në syrin e qelqtë të peshkut

asnjëherë nuk do dimë

cila është ëndrra më e bukur e tyre

çdo ëndërr

është vetëm një herë e njëjtë (fq. 58)

Kjo poezi ndër më të bukurat është një kozmogoni në saje të simboleve që, sipas Norttrop Fraj, janë arketipa të simboleve kozmike dhe biblike si: pema, zjari, hana, dielli, yjet, zogu, shiu, zoti, korbi e të tjera. Absurditeti si element i poezisë moderne dhe postmoderne haset shpesh te ky autor:

kjo natë me shi

i përngjan monologut memec

funeralit të rebeluar

në kryeqytete fill pas festës

(fq. 68)

Në poezinë "Premtime të mençura" autori përdor ironinë përmes demonit:

nga pema e papjekur

kokrrat i hëngra unë

farën nën dhe

(fq. 69)

Në poezinë e Molliqit shpesh gjejmë edhe imazhe mendimi që përkohjnë me poezinë intelektuale e që tek Arifi shoqërohet me ironi:

në katundin tim

fëmijëve ua vranë dhe djegën kukullat

kishin frikë

se harxhojnë ajrin

(fq. 70)

Poezia “Lluka e epërme” është një përkushtim me nota himni për vendlindjen e autorit:

je pjesë e imja si ky shpirti im

kur të vdes unë ti do të vazhdosh të jetosh

pse ta fsheh je një korife planeti

( fq. 90)

Duke lexuar këtë poezi të ndërmendet thënia e shkrimtarit të madh grek Kafkis: “Për një kohë ti banon në qytetin tënd të lindjes, më vonë qyteti i lindjes banon në ty”.

Poezitë e këtij cikli që lënë mbresa dhe që janë antologjike janë të shumta si “Shah me të vdekurit”, “Dielli prej llamarine”, “Në qiell s’ka zogj”; dhjetë poezitë të emëruara me ditë, “Zogjtë shkuan e s’u kthyen”, “Ditari i varrtarit”, “Lëndina e qyqeve”, “Premtime të mençura”, “Kukullat që marrin frymë”, “Gjarpri”, “Etja pi detin”, “Lluka e epërme” e shumë të tilla.

Në cikin e katërt me radhë “Shumë zhurmë për pak liri” vjen në shprehje tematika e aktualitetit dhe reagimi i autor ndaj dukurive të përditshme. Poeti është një kritik i pakompromis ndaj deformimeve, degradimeve dhe degjenerimeve që ndodhin dita-ditës në vendlindje. Në poezitë e këtij cikli vjen në shprehje prirja e autorit që ka për ironinë si mjet poetik, madje për ironinë e përshkallëzuar në sarkazëm e grotesk. Në poezinë “Dasma e kopilave” autori shprehet:

se të vdekurit s’janë të sigurt

të gajllët ua hanë qefinin e bardhë

(fq. 102)

Te këto poezi kemi mendimin autorial si gjykim intelektual ndaj shkaktarëve të këtyre dukurive. Emrat: kulla, guri, litari, Çakorri, korbi, djalli, krimbi,

qeni, ujku avdall, kopili e të tjerë, përdoren bukur si metafora e më shumë si metonimi për cilësitë e “ajkës” politike të vendit. Në këtë cikël disa herë gjejmë edhe oksimoronin si:

dielli na bëhet errësirë.

(fq.109)

“Dashuria autodidakte” është cikël me lirika të dashurisë. Heroi lirik në marrëdhënie me dashurinë është i fisëm dhe i çiltër. Erotika dhe akti erotik është sa real aq edhe ëndërrimtar:

me jetu asht me pas dashni

m’u puth edhe n’ sarkofag

me ia digju frymën shoqi-shoqit

çfarë do të ndodhë mbasandej

u mor vesh

dashnia moshë nuk ka

(fq.131)

Gjendja shpirtërore, emocionale në këto poezi është njëfarë katarsisi arisotelian, pra erosi është njëkohësisht edhe etos. Cikli i fundit “Arti i lehjes” ka lidhshmëri tematike dhe figurative me ciklin e parafundit “Shumë zhurmë për pak liri”, vetëm se këtu poeti rreket me veset, demagogjinë, smirëzinë, fillzinë,

servilizmin e njerëzve me “shpirt estetik”, të ashtuquajtur krijues, duke i thënë vetes “jam korife i poezisë”. Motivimet e autorit për t’i luftuar këto veçori të këtyre “poetëve avdallë”, siç i quan poeti, janë të mëdha andaj edhe poetika e këtyre poezive ka metafora shumë të fuqishme si: merimangë e zezë, krimba të kuq, lot të zi, dhëmbë të zi, zogj të zi, dhëmbë të territ, kurthe të varrit, gëlqere e shuar. Kurse “artin” e tyre poeti e quan “arti i lehjeve”. Pra dalja e këtyre poezive të bukura nga shëmtia si temë tingëllon oksimoroni saqë në këtë kontekst Umberto Eco thotë: “Arti ka pushtet për ta bërë të dashur shëmtinë”, pra mënyrën se si shkruhet për këtë kategori estetike. Në fund, këtë vështrim, më tepër si shenjë vëmendje për lexuesit që të kenë dhe të lexojnë një poezi të veçantë me një gjuhë të pasur dhe një stil të lartë të një poeti, artin e të cilit e shquan një ndjeshmëri e thellë emocionale, por përmes prizmes intelektuale mund ta përfundojmë me konkluzionin se Arif Molliqi ka krijuar një poezi të bukur ose, siç thotë Ronald Bartes, “një poezi të shkruar”, pra një poezi që jo vetëm që do të lexohet, por edhe do të shkruhet për të nga lexuesi semiotik.

## Shqetësime

# LIBRI, NË GRAHMAT E FUNDIT TË JETËS

**Jemi jo në vend numëro, por jemi duke ecur mbrapsht. Libri po jep shpirt, është i sëmure rëndë, është keq fare. A t’i shkojmë për ngushëllim?**

### Artur SPANJOLLI

Dikur në Shqipëri shtypeshin 30 mijë kopje për një roman të një autori të njohur dhe njerëzit vriteshin duke u shtyrë, kush e kush ta blinte atë më parë. Kopjet mbaronin brenda disa orësh. Dikur libri ishte thesari për ta përpirë, lexuar, duke shqyer sytë. Ndërsa tani, ai që shet dy mijë kopje, është me fat dhe i suksesshëm? Dikur faji, por edhe suksesi i librit, ishte i regjimit, i cili e kishte lënë popullin në mjerim total si shpirtëror, po ashtu edhe material. Njerëzit ishin të etur për dije. Po sot, ku duhet gjetur arsyeja? Me ardhjen që prej shumë kohësh, por sidomos këto pesëmbëdhjetë vjetët e fundit, të epokës së internetit dhe të celularit në dorë, kjo bota jonë, ka pësuar dhe po pëson një ndryshim themelor. Si ka shkuar, dhe si po shkon ajo në lidhje me leximin e librit? Cili do të jetë fati i librit? Libri po vdes? Libri është në grahmat e fundit? Ç të ardhme do të ketë letra e shtypur? Nëse 15 vjet më parë, njerëzia përveç TV-së dhe celularit, informacionet i merrte nëpër libra, biblioteka, etj, tani informacioni, përgjithësisht merret direkt nga interneti dhe nga celulari. Kjo ka bërë që vit mbas viti, libri ta ndjejë fort ofshamën e rënies, plagosjes së saj për vdekje. Trandjen e saj madhështore mbi dysheme. Dhe bashkë me të, vuajnë dhe përpëliten edhe vetë shtëpitë botuese, libraritë, të cilat e kanë humbur prioritetin e tyre kohë më parë. Mjerë kohërat që po vijnë. Më pak libra, më pak diskutime librash, më pak njohuri, thellime, reflektime. Më pak kulturë siç duhet, veç informacion sipërfaqësor, boshllëk, vetmi, zbrazëti. Faji, është në radhë të parë i epokës që po jetojmë. I ritmit të saj shfrenues, i distraksioneve të kota plot drita dhe ngjyra, i kohës që nuk gjendet dhe i teknologjisë që sa më shumë kalon koha, aq më shumë ajo i imponohet jetës tonë. Mungojnë shkrimtarët e racës apo mungon zelli, dëshira për të nxënë dhe për t’u kulturuar? Apo shpirti i sotëm është bosh, i humbur, i rënë në apati, i mjerë. Si këngët e San Remos. Janë me sa duket vetë gjeneratat e reja të lexuesve, të cilët tani kënaqen me informacionin e sipërfaqshëm gjetur veç në internet. Do të jetë e afërt zhdukja e librit të shtypur në letër? Kjo ndoshta jo, por humbja e rolit të tij parësor, kjo, me siguri që po. Tani gjeneratat e reja preferojnë ta lexojnë



materialin ndoshta më rehatshëm në e – book, se sa në letër? Që librat në qarkullim janë gjithnjë edhe më të sëmure, kjo dallohet qartë sapo hyn në një librari. Ato po mbyllen ditë mbas dite. Ashtu si dhe kinematë. Prej vitesh, nuk ka më asnjë rast letrar. Nuk ka me asnjë best seller, që të mund të shesë me mijëra kopje. Në gadishull, rasti i fundit letrar, pas Suzana Tamaros, Dan Brownit dhe Mellisa P. R. Savianos, nuk kujtoj asgjë tjetër këtu në Itali. S’lexohet ndoshta më, apo s ka më letërsi të mirë? Atë që libri në të shkuarën i falte njeriut, tani ai e mbush ndoshta me internet, me fb, me tik tok, me instagram, me show tv? Ndoshta qëndrojnë që të dyja. Ndoshta s ofrohet më letërsi e mirë si ajo e realizmit magjik, për shembull, por mund të jetë edhe e kundërta. Njeriu i sotëm nuk ndjen ekzistencën e risive në letërsi. Klasikët mjaftojnë dhe ndoshta janë tepër. Një shoqëri që nuk reflekton mbi shqetësimet e saj, fenomenet e saj, është një shoqëri e verbër, e sëmure, e varfër dhe e destinuar të gërryhet nga brenda. Një popull pa syrin kritik, ka diçka vërtetë që nuk shkon. Kjo tregon se në të ardhmen do të kemi, me siguri, gjithnjë edhe më shumë gjenerata të varfra si në arsyetim, ashtu edhe në reflektim. Një

gjeneratë injorantësh, të cilët marrin nga celularët veç një informacion të mjerë dhe të sipërfaqshëm. Shumë herë të rremë dhe krejt të përciptë. Jemi prapë në vend-numëro?! Para 100 vjetësh, injoranca dhe mjerimi material e bënë gati të pamundur luksin e kulturës dhe arsimimin e popullit në masë. Ndërsa tani, tregu ofron gjithçka: libra, materiale, shkrime, por njeriu i sotëm nuk e blen librin, njëlloj si 100 vjet më parë. Pra, kultura vazhdon të mbetet luks i një inteligjence, i një grupi të ngushtë njerëzish?! Dikur, pamundësia ekonomike, sot hutimi, shpërqendrimi, rendja drejt kotësive, mungesa e kohës, humbja tragjike e interesit, ka bërë që njeriu mos ta hapë rishtas librin. Injorantë me zile. Nuk them se të gjithë duhet ta duan librin, por një njeri i formuar duhet ti njohi të paktën klasikët e letërsisë. Pesimist? Libri do të humbë akoma terren? Apo, ai njeri, i cili e ndjen ekzistencën e librit në çdo shoqëri, do ta kërkojë atë, do ta lexojë, do ta përvetësojë, do ta dashurojë atë? Me siguri do të kemi një shoqëri më të trullusur, më të matufosur, një gjeneratë më bosh, e cila do të rendë veç drejt internetit, talk show-ve televizive. Një rini të dehur me helmën e konsumizmit. Një shoqëri më të varfër, të mjerë, mizerie.

Një rini tik-tok-se, instagram-se, fejsbuk-se, e cila s do ta ndjej më kurrë, por as edhe nuk do ta kërkojë, erën e mirë të letërsë së shtypur ndër hundë. Një shoqëri të cilës do t’i interesojë gjithnjë edhe më pak kultura, thellimi, identiteti i saj dhe sidomos historia dhe memoria e saj. Një shoqëri e lehtë për t’u manipuluar, për t’u tërhequr prej hunde. Kur një shoqëri nuk reflekton mbi fajet e saj, mbi brengat, mbi gabimet, ajo nuk do ta ketë kurrë shansin të rritet kulturalisht. Gjithashtu do të kemi edhe një gjeneratë më të thjeshtë për t’u manipuluar, prej një injorance të mirëfilltë intelektuale. Pra, ajo mund të tërhiqet fare lehtë prej hundësh, nga padronët e botës. Jemi jo në vend numëro, por jemi duke ecur mbrapsht. Libri po jep shpirt, është i sëmure rëndë, është keq fare. A t’i shkojmë për ngushëllim? Apo ai po përgatitet të vdesë pa ne? Në heshtje. Me mërinë dhe dhimbjen e shkrimtarëve, editorëve, lexuesve, shumica e të cilëve me siguri janë në moshën e tretë. Shpresojmë që kjo mos të ndodhë kurrë! Po institucionet, ku janë? Ç bëjnë për ngritjen e nivelit të kulturës, ndërgjegjësimin e njeriut për lexim?

## Forma letrare

## TREGIMI

**Menjëherë pas shfaqjes se tregimeve të Poe-s, pati një fazë të pazakontë rebelimi të vazhdueshëm kundër çdo lloj dogme që mund t'i aplikohet këtij lloji, dhe që atëherë ndryshimet pasuan pa pushim**

**Enrique Vila-MATAS**

Tregimi, kjo formë letrare kaq kërkuese pranon grada dendësie pothuaj poetike - gjë që nuk e pranon aspak proza rrëfimtare e romanit - dhe megjithatë nuk është pothuaj kurrë një poezi, sepse ruan një ritëm të tijin thellësisht rrëfimtari. Një poezi të Pesoa-s e kam lexuar sikur të ishte një tregim, mbase prej faktit se kemi gjithmonë nevojë që të kemi përjashtime nga rregulli.

Po a ka rregulla? E çfarë është me të vërtete një tregim? Të gjithë - thotë Javier Cercas—e dine se ç'është një tregim, por përshtypja është se askush nuk e di shumë mirë se ç'është me të vërtete.

Endaj me Cercas-in përshtypjen nuk kam lexuar kurrë një përcaktim mbi tregimin që të përmbajë në mënyrë të kënaqshme labirintin e shumëllojshmërisë, të sfumaturave, formave dhe kushteve që nënkupton kjo fjalë. Është tamam kjo, njëra nga vlerat e tregimit modern, dhe ndoshta ajo që e bën dhe më tërheqës. Menjëherë pas shfaqjes se tregimeve të Poe-s, pati një fazë të pazakontë rebelimi të vazhdueshëm kundër çdo lloj dogme që mund t'i aplikohet këtij lloji, dhe që atëherë ndryshimet pasuan pa pushim - për këtë arsye është aq i gjallë tregimi - dhe që atëherë nuk ka pushuar së qeni një lëvizje e madhe; është një histori - historia e dalldisur e tregimit modern - që na kujton se çfarë i ndodh një tregimtar kur nis të shkruajë një tregim dhe që Heminguej e ka shpjeguar shumë mirë

kur thotë se nganjëherë ndërtohet historia e tregimit dora-dorës që t'i shkruan, që është pak sikur të thuash se rruga bëhet duke ecur. "Gjithçka ndryshon dora-dorës që ti shkruan. Është kjo që e jep lëvizjen që përben tregimin. Nganjëherë lëvizja është aq e ngadaltë sa duket sikur nuk ecet përpara, por ka gjithmonë ndryshim, ka gjithmonë lëvizje", thotë ai.

Tek "Njëqind vjet tregime", Jose Maria Merino na flet për ndryshime dhe lëvizje dhe për faktin narrativ, atë fenomen që i lejon një teksti të bëhet tregim, sepse përshkohet nga një lëvizje e brendshme, një ndryshim dramatik, një përmbysje e aftë t'i japë transcendencë absolute lëndës konkrete që trajtohet, dhe që e shndërron një situatë të dhëne fillestare, apo e lejon të kuptohet në mënyrë dinamike, duke e pajisur me një kuptim special". Ndryshime dhe lëvizje verifikohen në jetë dhe në tregimet më të mira, që janë ata që vizatojnë jetën në mënyrë që ajo, ashtu si në tregimet më të mira, të duket sikur gëlon në formë të menjëhershme apo të beftë, duke u rrëmbyer nga ai "qarkullim mirëfilli i çmendur" që ravijëzon dramën e ekzistencës në fund të më të paharrueshmë dhe më të tmerrshmit tregim të Kafkës, "Procesi". Është ai qarkullim mirëfilli i çmendur, me ndryshime të vazhdueshme dhe lëvizje, që përcakton faktin se askush nuk e di më të vërtetë se ç'është jeta, dhe akoma me pak se çfarë mund të jetë një tregim, gjithmonë duke mos nënkuptuar se jeta është një tregim.



## Profile

## OLIVER SACKS - MJEKU DHE SHKRIMTARI

**Nga ky autor në gjuhën shqipe është botuar libri "Burri që e pandehi gruan për kapelë" - dhe rrëfenja të tjera klinike (përkthyer nga Griselda Zaimi, Botoi Sh. B. "Skanderbeg Books", Tiranë, 2016)**

**Khahid BUSHATI**

Në vitin 1961 Sacks mbërriti në SHBA. Kreu një stazh në Spitalin Mt. Zion në San Francisko dhe një rezidencë në neurologji dhe neuropatologji në UCLA. Ndërsa ishte në San Francisko, Sacks u bë mik i ngushtë e i përjetshëm i poetit Thom Gunn, duke thënë se ai e donte imagjinatën e tij të egër, kontrollin e tij të rreptë dhe formën e përsosur poetike.

Sacks u transferua në qytetin e Nju Jorkut. Lexoi një libër nga mjeku i migrenës, Edward Liveing. E frymëzoi ai libër! Sacks, edhe pse do të mbetej banor i SHBA për pjesën tjetër të jetës, ai nuk u bë kurrë shtetas amerikan. Pas një pune me arritje të larta shkencore në fushën e mjekësisë, u emërua i pari "Artist i Universitetit të Kolumbias" në Universitetin e Kolumbisë në kampusin "Morningside Heights" të Universitetit, duke njohur rolin e punës së tij në lidhjen e arteve dhe shkencave.

Në vitin 1967 filloi për herë të parë të shkruante për përvojat e tij me disa nga pacientët e tij neurologjikë. Libri i tij i parë "Ward 23" u dogj nga Sacks gjatë një episodi vetëdijshmi. Puna e tij është paraqitur në një "gamë më të gjerë mediashe se ato të çdo autori tjetër mjekësor bashkëkohor". Në vitin 1990, "The New York Times" shkroi se ai "... është bërë një lloj poeti laureat i Mjekësisë Bashkëkohore".

E konsideroi stilin e tij letrar si të dalë nga tradita e "anekdotave klinike" të shekullit të 19-të, një stil letrar që përfshinte histori të detajuara narrative, të cilat i quajti romane. Pas botimit të librit të tij të parë



"Migrena" në vitin 1970, një rishikim nga miku i tij i ngushtë W. H. Auden, e inkurajoi Sacks-in të përshtaste stilin e tij të shkruarit por "të jetë metaforik, të jetë mitik, të jetë gjithçka që ju nevojitet". Sacks i përshkroi rastet e tij me një mori detajesh narrative, duke u përqendruar në përvojat e pacientit. Pacientët që përshkroi shpesh ishin në gjendje t'i përshatashin situatës së tyre në mënyra të ndryshme, pavarësisht nga fakti se kushtet e tyre neurologjike zakonisht konsideroheshin të pashërueshme. Libri i tij "Awakenings", mbi të cilin bazohet filmi artistik i vitit 1990 me të njëjtin emër, përshkruan përvojat e tij duke përdorur ilaçin e ri levodopa tek pacientët post-encefalitike në ish-Spitalin "Beth Abraham", aktualisht Qendra Beth Abraham për Rehabilitim

dhe Infermierë, Allerton Ave, në Bronksi-n Verilindor. "Awakenings ishte, gjithashtu, subjekt i dokumentarit të parë të realizuar (në vitin 1974) për serialin televiziv britanik Discovery. Duhet thënë se, Sacks, ndonjëherë, përballej me kritika në komunitetet e studimeve mjekësore dhe të aftësisë së kufizuar. Artur K. Shapiro tha se puna e Sacks ishte "idiosinkratike" dhe u mbështet shumë në provat anekdotike në shkrimet e tij. Studiuesi Makoto Yamaguchi mendonte se shpjegimet matematikore të Sacks-it, në studimin e tij për binjakët e talentuar numerikisht (si tek vepra "Burri që e pandehi gruan për kapelë") ishin të parëndësishme dhe vuri në dyshim metodat e tij. Edhe pse Sacks është karakterizuar si një shkrimtar dhe mjek "i dhembshur", të tjerë kanë ndjerë

se ai i ka shfrytëzuar subjektet e tij. Sacks u quajt "... njeriu që ngatërroi pacientët e tij për një karrierë letrare".

Sacks nuk u martua kurrë. Jeto i vetëm në pjesën më të madhe të jetës së tij. Nuk pranoi të ndajë detaje personale deri vonë në jetën e tij. Në një intervistë të vitit 2001 vuri në duke se, "... ndrojtja e rëndë kishte qenë një pengesë gjatë gjithë jetës për ndërveprimet e tij personale. Besonte se ndrojtja e tij buronte nga prosopagnosia e tij, e njohur si "verbëria e fytyrës", një gjendje që e studioi tek disa pacientë të tij, duke përfshirë edhe njeriun e veprës së tij "Burri që e pandehi gruan si kapelë". Kjo paaftësi e tij neurologjike, ashpërsia e së cilës dhe ndikimi i të cilit në jetën e tij Sacks nuk e kuptoi plotësisht derisa arriti në moshën e mesme, madje ndonjëherë e pengoi atë të njëjtte reflektimin e tij në pasqyrë. Në janar të vitit 2015, në mëlçinë e tij u zbuluan metastaza nga tumori okular. Sacks e vlerësoi kohën e tij të mbetur në "muaj". Ndërkohë synimi i tij ishte: "Dëshiroj dhe shpresoj në kohën që më ka mbetur të thelloj miqësitë e mia, t'u them lamtumirën atyre që dua, të shkruaj më shumë, të udhëtoj nëse kam forcë, të arrij nivele të reja mirëkuptimi dhe depërtimi".

Sack vdiq më 30 gusht 2015, në shtëpinë e tij në Manhattan, në moshën 82-vjeçare, i rrethuar nga miqtë e tij më të ngushtë. Në vitin 2024, Biblioteka Publike e Nju Jorkut njoftoi se kishte marrë në dorëzim arkivin e Sacks. Në të gjendeshin 35.000 letra, 7.000 fotografi, dorëshkrime të librave të tij, revista dhe fletore.



## Reflekse

# XHAZIN E ZBULOVA NË AMERIKË

**Në New York mësova se xhazi është dëfrim kombëtar. Kurse në Paris është sall një mjet për vallëzim, por kjo është lajthitje: amerikanët nuk vallëzojnë me xhaz, për vallëzim kanë ritme të veçanta që dëgjoen dhe në martesë e kungime**

## Nga Jean-Paul SARTRE

Xhazi është si bananet - duhet të konsumohet aty për aty. Njai Zot e di se ka incizime të shumta në Francë, njashu dhe kopjues të këqij. Gjithçka bëjnë ata janë ca justifikime për lotët e derdhur përbrenda një shoqërie të këndshme. Si shumica, vërtet xhazin e zbulova në Amerikë. Janë disa vende që kanë dëfrim, disa të tjera jo. Është njëfarë dëfrimi kombëtar kur publiku kridhet në heshtje të plotë gjatë pjesës së parë të aksh shfaqjes dhe më pas stampon ngazëllimin përgjatë pjesës së dytë. Po e pranua këtë përkufizim, ahëre Franca nuk ka dëfrim kombëtar, sall shitjet në ankande. As Italia, përveç plagjiatit. Heshtje e plotë, vështrim i mprehtë gjersa hajduti shpërfaqet (pjesa e parë) dhe me t'ia mbathur, thirrje: Ndal, hajdut! (pjesa e dytë). Belgjika i ka gjelat grindavecë, Gjermania vampirizmin, Spanja i ka demat e saj.

## Amerikanët nuk vallëzojnë me xhaz

Në New York mësova se xhazi është dëfrim kombëtar. Kurse në Paris është sall një mjet për vallëzim, por kjo është lajthitje: amerikanët nuk vallëzojnë me xhaz, për vallëzim kanë ritme të veçanta që dëgjoen dhe në martesë e kungime: Music by Muzak (ritme në sfond). Në apartamente ka përherë një rubinet që porsa hapet vërshon Muzak-u: flirte, lot, vallëzim. Rubineti mbyllet dhe Muzak-u njashu. Flirtuesit dhe të dashuruarit

shtrihen në krevat.

Në Nick's bar, në New York, shpërfaqet dëfrimi kombëtar, që nënkupton se dikush ulet diku në sallën e mbuluar me velin e tymit, midis marinarëve, patateve të skuqura, grave të shoqërisë. Tavolina. Karrige. Askush nuk pipëtin. Detarët vinë nga katër. Mbuluar me njëfarë tisi urrejtjeje, ata i shohin përreth, mprehtë, të tjerët në suita me të dashurat. Detarët do të donin t'i kishin të dashurat e tyre, por ja që nuk i kanë. Ata nisin e pinë; janë të ashpër. Edhe vajzat duken njashu si të vrazhda. Pinë pa pipëtitirë. Askush nuk flet a lëviz, xhazi gjëmon përpara tyre. Në Francë xhazmenët janë grandiozë, por disi memecë e pedantë, me këmisha dhe kollare mëndafshi. Nëse mërztiteni gjersa dëgjoni, gjithmonë derisa i sodisni, mund t'i merrni ca leksione për elegancën.

Por në barin e Nikut këshilloheni të mos i sodisni: ata janë aq shëmtarakë njashu si muzikantët në një orkestër simfonike. Fytyra kockore, mustaqe për ibret, kostume biznesi, jakë të ngrira, duar muskulore që i shpërthejnë mëngët. Ata luajnë. Ju dëgjoni. Askush nuk kridhet ëndrrave... Chopin-i të bën të ëndërrosh. André Claveau njashu. Por jo xhazi te bari i Nikut. Magjepsja e atyshme të pataksë mendjen. S'ka përdëllim. Po qe qyqar, ahëre largohesh i tillë. S'ke si ta kapësh dorën e një dame, e përmes vështrimit të syve ta bësh të kuptojë se muzika e pasqyron të brendshmen. Jo. Ajo është e thatë, disi e dhunshme, e pamëshirshme. Jo homoseksuale, jo e trishtë, çnjerëzore. Disi si ulërima e një shpendi grabitqar.

Muzikantët lëshohen njëri pas tjetrit. Fillimisht trumbetisti, pianisti, pastaj trombonisti. Basisti sikur bluan. Nuk flitet për dashuri, s'ka përdëllim. Gjithçka sikur nxiton. Njashu siç njerëzit marrin metronë a hanë në Automat.

## Ritmi të mbërthen dhe të tronditë

Nuk është kënga shekullore e sklevërve zezakë. As ëndrra e trishtë, vocërrake, e Yankees, shtypur nga makina. Kurrëgjë e tillë: seç është një burrë i shëndoshë që sikur nxjerrë mushkëritë në lojën e trombonit, njëfarë pianisti i pamëshirë, batisti që torturon telat pa ia varur të tjerëve përreth. Ata sikur flasin për pjesën tënde më të mirë, më të ashprën, të lirën, për atë që s'do melodi a refren, sall kulmin gjëmues të çastit. Ata të mbërthejnë, por nuk të përgjumin. Maja që rrotullohen, shufra lidhëse, bosht horizontal; rrahen, kthehen kontrapunkt, përplasen, ritmi gjëmon përpara. Nëse je i fortë, i ri dhe i freskët, ritmi të kap, të trallisë. Ti kërcen në ndenjësën tënde, përherë e më shpejt, dhe vajza në krahun tënd, tok me ty, si në rrrathë ferri...

Tromboni djersinë, ti djersinë, boria njashu; dhe pastaj ndjen se diçka ka ndodhur në podiumin e bendit; muzikantët nuk duken njëlloj; ata shpejtojnë para, infektojnë njëri-tjetrin, duken si të çmendur, të dalldisur, të tendosur, sikur po kërkojnë diçka... që i shëmbëllen kënaqësisë seksuale. Edhe ju njashu kërkoni diçka. Filloni nga britmat; ndjeni se duhet të bërtisni - orkestra

është bërë një majë rrotulluese e pamat; po ndalove, edhe maja ndalon, rrëzohet. Bërtisni, fishkëlleni, jeni të pushtuar, gjëmoni pors gruaja në lindje. Trumbetisti prek pianistin dhe transmeton obsesionin e tij në njëfarë lloj mesmerizmi. Vazhdon britma. Gjithë turma bërtet, ju s'e dëgjoni dot as xhazin, soditni disa burra në bend që kanë djersirë me kohë; do të doje të rrotulloheshe, të ulërish për vdekje, ta godasësh fytyrën femërore pranë teje...

## Nuk është keq!

Dhe pastaj, papritmas, xhazi ndalon, demni ka marrë shpatën; gjeli luftarak, ndër më të moshuarit, ka mbaruar. Gjithçka ka mbaruar. Ju keni pirë uiski, duke ulëritur, pa e ditur as vetë. Kamerieri, disi i pandjeshëm e i padurueshëm, jua ka sjell një tjetër. Për një çast që vegon, je i hutuar, tundesh-shkundesh, i thua vajzës: Jo keq! Ajo nuk të jep xhevap dhe fillohet nga e para. Nuk do të bësh dashuri sonte, nuk do të mallëngjehesh për veten, vërtet s'do të deheshe, as nuk do të derdhësh gjak - do ta kesh kaluar një furi krejt shtruar, një kreshendo konvulsionale që i ngjason kolerikut; kërkim i kotë për sevda. Do të largoheni paksa i rraskapitur, paksa i dehur, me njëfarë lloj qetësie dëshpëruese si pasojë e një lodhjeje të madhe nervore. Xhazi është dëfrimi kombëtar i Shteteve të Bashkuara. (The Saturday Review, Nov. 29, 1947)

## Shqipëroi: Bujar MEHOLLI



## Poezi: Arjana Fetahu GABA

### KA CA ÇASTE QË DALË NGA VETJA

Gjithmonë të menduarit më njeh me veten,  
Dhe çuditërisht paskam dy,  
Njëra që skuqet si vjeshta gjethet,  
Tjetra me tërbim në sy.

Kur mendimet më çojnë në tempuj engjëjsh,  
Ku s'do doja të kthehesha kurrsesi,  
Vetja tjetër si për dreq,  
Më thotë zgjohu e më mos "fli".

Unë kujtohem që ka të drejtë,  
Dhe ajri I thatë disi më mbyt,  
Nuk jetoj në kopshtin e Edenit,  
Këtu erërat janë me grykë.

Po ka ca çaste që dalë nga vetja,  
O Zot më shumë do të ishte tmerr,  
Me gllabërojnë më prishin mendjen,  
Ca mendjelojtur që vjellin vrer.

Por shpejt kuptoj që s'jam kërkund,  
Dhe sërish kthehem në "orbitë",  
Me veten flas dhe kundërshtoj,  
Mendimet që më ngjallin frikë.

Gjithmonë të menduarit më njeh me veten,  
Çdo ditë që zbardh lind dhe unë,  
Ndaj bëj kujdes nga e panjohura,  
Dhe nga e nesërmja ca më shumë.

### SA SHPEJT U PRISH KJO TRILLË VJESHTE

Tashmë nëntori ka hyrë në mes,  
Kërkon dhjetorit t'i rrëfejë,  
Që është njësoj sikur vera,  
Por, gjethet s'dinë të gënjejnë.

Ato po zhveshin të gjithë vjeshtën,  
Të verdhë tokën e kanë shtruar,  
Tek-tuk ca zogj mbetur mbi degë,  
Të zbuluar e të hutuar.

U prish shpejt kjo trillë vjeshte,  
Se, shiu zu të bjerë litar,  
Po shtyhen retë nga bërrylat,  
A thua vallë të jetë janar?!

Se, dimri ka hiletë e veta,  
Siç bëri kur shkurtit i mori hua'  
Tri ditë thotë legjenda i duheshin në mal,  
Të ngrinte plakën me gjithçka.

Dhe nëpër qiell zu të qeshë,  
E ngriu motin pak nga pak,  
Mësoi vjeshta si të heshtë,  
E të kujtojë ç'është dimri plak.

### AH MOJ MOLLA E PANGRËNË

E por kur më ngjitesh,  
N'ato kalldrëme zalli,  
Gusha trëndelinë të vjen,  
Oh ç'më mori malli.

Dal të bëj përpara,  
E të të zë pritë,  
Kur më sheh me sytë e zinj,  
Ç'më verbon një dritë.

Kur kthen kokën më buzëqesh,  
E harroj fare burrërinë,  
Ah moj molla e pangrënë,  
Seç ta kam zilinë.

Pjergulla në fik të bardhë,  
Mos shko me ngadalë,  
Se t'gjithë zogjtë e sokakut,  
Të këndojnë me fjalë.

Se unë jam djalë i ri,  
S'dua kush të t'marrë erë,  
T'kam në zemër hajmali,  
Syri për të nxjerrë.

### MË DUHET TË JETO

Një qiell gri si hir cigare,  
Shpirti im trazuar sot,  
Stuhi që deteve më hedh pa anë,  
E s'po shpëtoj, që s'shpëtoj dot.

E di,  
që vjeshta e sivjetshme,  
Do rrokulliset e do të shkojë,  
E njoh dhe dimrin, pa ardhur akoma,  
Do të jetë, po njësoj,  
Dhe nuk kam shpresë, as nga pranvera,  
Që mund të më gëzojë.  
Se e di, pa ty vështirë,  
Këtij qielli drita ti kaloj.

Dhe sot,  
se ç'kam një mall me valë,  
Në brigje shpirti të drobitur,  
S'po di të gjej më asnjë fjalë,  
Nën k'të qiell të përzhitur.  
Dhe paq ky mall m'ka ligështuar,  
Më ka drobitur fill,  
Në kraharor më ka ngushtuar  
S'më pyet e më shpërfill.

Një asfiksë më duket jeta,  
Dhe vetja pò ashtu,  
Jam zënë sikur në rrjeta peshqish,  
E s'po bëj tëhu.

Ndaj,  
Më duhet të të le të lirë,  
Sepse më duhet të jetoj,  
Pa ty, shpirtin tim ta dua,  
Dhe kur gjërat s'janë njësoj.

### SA JAM PENDUAR

Më mori malli dhe për çudi,  
Nisa fytyrën të të formoj,  
Të ndjeja sërish buzën e kuqe,  
Po kurrsesi nuk qe njësoj.

Diç më shtrëngoi në zemër keq,  
Emrin ta thashë pak belbëzuar,  
Si paska qenë kjo jetë për dreq,  
Dhe veten time, paskam harruar.

Një erë e lehtë, gënjeshtër dimri,  
Pak shi I hollë, sa për bezdi,  
Jo s'është kurrë ai shi prilli,  
Kur dashuronim unë dhe ti.

Me shall mbështjellë, ashtu I fikur,  
Në trotuar më kot nxitoja,  
S'hodha dot sytë rreth e përqark,  
E dinin sytë seç unë kërkjoja..

Trokitje takash mbi trotuar,  
Dhe një e qeshur pak e lazduar,  
Ish thjesht e gjitha një ngacmim,  
Për t'më kujtuar, sa jam penduar.

Nuk ishte e jotja padyshim,  
Të qeshurën kishe, plotë me jetë,  
Tani marr frymë, pa ditë me diell,  
Pa dashuri, poshtë e përpjetë.



Tregim

# FUSTANI

## Fasli HALITI

Më në fund u gjend zgjidhja. Sapo Varvarën ta zinin të prerat, fustani çudibërës larush duhej të mbaronte së qepuri dhe sapo të lindte fëmija, fustani duhej t'i vishej menjëherë foshnjës së sapo lindur... U gëzua jo vetëm Toli Bica që priste të bëhej baba, shtëpia e tij, por u gëzua e gjithë lagjja jonë periferike e qytetit të vogël. Varvara, nuk ishte nusja, por zana e lagjes periferike, e bukura e dheut. Burrat e shihnin atë si qershinë e lagjes, si një qershi që harbonte në lulëzim, që lidhte kokrra, por s'i mbante, i rrëzonte në prag të pjekjes. Kishin kaluar dhjetë vjet nga dita që ajo erdhi nuse në lagjen tonë. Erdhi gjashtëmbëdhjetë vjeçe, po bëhej njëzet e gjashtë dhe ende s'kishte fëmijë. Kishte mbetur, gati çdo vit shtatzënë dhe në muajin e nëntë e dështonte fëmijën. Nuk e mban, thoshin gratë. E vizituan mjekët më të mirë të qytetit tonë të vogël, gjinekologët më të mirë të asaj kohe; u bënë të gjitha përpjekjet që ajo të mos e dështonte fëmijën, por fëmija i vdiste në bark. Thoshin s'e ishte e ngushtë, se e kishte legenin të vogël, por të gjitha këto nuk ishin veçse hamendje të njerëzve, ishin fjalë koti. Kur mbeti shtatzënë për të tetën herë, sikur u gjet një zgjidhje, sikur lindi një shpresë se më në fund, ajo do ta mbante fëmijën dhe do ta lindte të gjallë. Po si? Kule Shtëmbari, magjistrica, fallxhorja e lagjes, u zotua se Varvara e bukur, do ta lindte të gjallë fëmijën, do të qepej një fustan me tri capa basmeje nga paja e tri vajzave të fejuara të lagjes. dhe tri copat u morën nga tri vajzat e fejuara, nga tri virgjëreshat e lagjes sonë: copa e verdhë u mor nga paja e Dafinës, copa e bardhë, nga paja e Shegës dhe copa blu u mor nga paja e Diellës. Pritej vetëm që Varvarës t'i fillonin dhimbjet e lindjes. Nga mesi i muajit të nëntë. Varvarës i filluan të prerat. Ishte mbrëmje me një muzg ngjyrë vishnjë. Toli Bica me të vëllanë mbrehën qetë në qerre, e hipën Varvarën në shtratit e qerres së mbuluar me rrogos, shtruan një dyshek me lesh. Rrobaqepësja e lagje, Bane Shurdhani nisi me nxitim qepjen e fustanin laraman me copat e pajës së tri vajzave të fejuara. Më kujtohet ai fustan me tri ngjyra: me ngjyrë të verdhë, të bardhë, blu. Tepër futurist për mjedisin e prapambetur të lagjes sonë, por mua më pëlqeu shumë. Lum fëmija që do ta vishte. Po a do ta vishte vallë? Të gjithë prisnin me ankth çastin e lindjes së fëmijës. Toli ndizte e shuante cigaret njerin pas tjetrit, paf, puf. Motra e tij Sena, rrinte te dera e spitalit, me fustanin që, sapo të dilte fëmija, t'ia vishte menjëherë atë fustan magjik që, sipas magjistrices Kule Shtëmbari, në saj të tij, fëmija do të lindte i gjallë. Por fëmija edhe këtë herë, vdiq në bark të nënës si tetë të tjerët. Varvara përsëri s'dëgjoji zë, të qara fëmije. Gjoksi i saj i gufuar rrodhi disa ditë, por nuk njomi buzë foshnjeje. Toli Bica, prapë s'u bë baba. Dendësoi, për një kohë të gjatë ndezjen dhe shuarjen e cigares. Prapë qershia e lagjes plot lule të bardha, lidhi kokrra, po përsëri, nuk i mbajti ato, i kishte rrëzuar, thoshte graria e lagjes periferike. Mos e hanë me sy. Syri i lig të këputë. Ai këput kalin, çan lisiin e jo më një nuse si Varvara, thoshin bestynët, supersticiozët e lagjes. Pas çdo dështimi Varvara bëhej më e bukur, si të zëvendësonte me këtë bukuri, mungesën e fëmijës. S'kalonte shumë kohë dhe ajo mbetej përsëri shtatzënë. Gëzohej vetë, gëzonte burrin e saj, shtëpinë, lagjen, por gëzimi nuk zgjaste dhe kjo përsëritej e përsëritej; gëzim, trishtim..., gëzim e



përsëri trishtim..., po dështimi i fëmijës së tetë, qe trishtim i përzishëm, sa Toli Bica, la mjekër dhe Varvara u vesh e u mbulua me të zeza si një natë e thellë...

\*\*\*

Kur e mori vesh Kule Shtëmbari, magjistrica e lagjes, lëshoi piskamën e saj se, gjoja, një nga vajzat që dhuruan copat nga paja e tyre, për fustanin e fëmijës, me siguri, nuk ka qenë virgjëreshë. Po, po, njëra nga vajzat e fejuara nuk ka qenë virgjëreshë, prandaj nuk zuri magjia ime. Fjalët e saj fluturuan si

miza të zeza që s'pushonin së zukturi zëzë-zi, në lagjen tonë. U fol se Dafina ishte ajo që, s'na qenkësh virgjëreshë. Kur Dafina dëgjoji se Vara lindi fëmijë të vdekur nga që ajo s'ishte virgjëreshë, se kishte harbuar me Miti Janon, bariun e pamshëm e trim të beut, për të cilin gjoja ajo vdiste, u mbyll në odën më të vogël e më të errët të shtëpisë. Tre muaj rresht; ditë për ditë e orë për orë, Dafës i vinin në vesh fjalë plagoma, thashetheme, si një mori gërthacësh që e pickonin, e thumbonin në pjesën më fisnike: në

nderin e saj; i vinin fjalë si tufa mizash të zeza, zu, zu-zi që përfllisnin e nxinin pjesën më të bardhë të saj; nderin. Flitej se kishte mbetur shtatzënë me bariun e beut, për të cilin, gjoja ajo çmendej... \*\*\* S'kaloi shumë kohë dhe zuri të bjerë një shi që nuk pushoi së rëni tri ditë e tri net, një shi që e tërboi, e fryu përroin në jug të lagjes i cili nisi të shkulte pemët në të dy anët e brigjeve të tij dhe që, kasollet e jevgjve përbri, mullarët me kashtë, për thurje rrogosash, i mori dhe i çoi përsëri në kënetë. Gjatë këtyre tri ditëve e tri netëve në odën ku rrinte e ngujuar nga turpi Dafa, vinin e futeshin fjalë të zeza si lakuriq nate të ndjekur nga stuhia dhe rrebeshi i natës. Njerëzit dhe kafshët s'guxonin, jo vetëm të dilnin jashtë, por as të nxirrnin kokat nga dera e shtëpisë. Lopët në kasolle, pëllisnin për haje dhe për ujë, qentë kuisnin, përroi ishte fryrë sop më sop, pastaj vërshoi mbi brigje e filloi të përmbyste lagjen. Kuçka, thoshin, disa shtriga të lagjes, rospia, thoshin disa lënësja, telbiska thoshte magjistrica Kule Shtëmbari, e bëri dhe e groposi kopilin në faqen e mezhdës së përroit. Shiu nuk do të pushojë, gjersa të gërryhet faqja e përroit e të zbulohet, të dalë në shesh kopili i kuçkës, ta marrë e ta çojë atë në kënetë, thoshte gjithandej nëpër lagje magjistrica Kule Shtëmbari... Këto fjalë dhe sidomos fjalët e magjistrices fluturonin si korba dhe lakuriq nate dhe shkonin drejt e te oda e Dafës së ngujuar nga turpi. Tre muaj rresht, Dafina u kacafyt me thashethemet e fjalët korba. Por tri ditë e tri net pus, me shi e rrebesh, me pëllitje lopësh, blegërима delesh, hingëllima kuajsh e kuisje qensh, kakarisje pulash, për haje, ushqim dhe ujë, ajo s'duroi dot më dhe zuri të fliste përçart. Po e besonte si të vërtetë shtatzëninë me bariun e pamshëm e trim të beut, me Miti Janon. Në odë s'pranonte kënd, as nënën. Në mesnatën e tretë bunacë, kur shiu binte me shqotë dhe përroi kishte ardhur sop më sop, Dafina doli nga shtëpia me boçen e pajës në dorë, vrapoi drejt përroit, klithi: qyqja unë, mora më qafë Varvarën, e lashë qyqe, pa fëmijë. Kaq shumë e kishin bërë punën e tyre thashethemet, sa vetë virgjëresha, po i besonte si të vërteta ato që kishte përhapur magjistrica Kule Shtëmbari, për të. Me të arritur në buzë të përroit, Dafa zgjidhi boçen me plaçkat e pajës, i nxori dhe i hodhi një nga një në përruan e tërbuar, të turbullt, klithi përsëri tri herë: qyqja, qyqja, qyqja unë, e lashë Varën pa fëmijë! Pastaj u hodh në ujin e përroit si pulëbardhë, sikur të kërkonte të kapte në thellësinë e atij uji të turbullt, e të tërbuar, fatin e saj të zi... \*\*\* Në të zbardhur të ditës, shiu pushoi, përroi shteri. Bujqit e lagjes dhe barinjët panë ca napa, ca çarçafë të bardhë, bokshe, një brez si ylber i nderur mbi një murriz.; dy tri shami teripi transparente të cilat era i kishte flakur mbi ferra si shenja që jepnin kumtin e zi. Dafinën dhe gjithë pajën e saj, e kishte marrë përroi dhe e kishte çuar atje ku derdhej, në kënetë. Pa nxjerr, e pa e çuar në kënetë kopilin e rospisë, shiu s'do të kishte pushuar as ditë e as natë, por shyqyr që kopili doli dhe shiu pushoi, thoshte Kule Shtëmbari. Por fjala e saj në këto caste të rënda, tragjike, nuk ngjiste te banorët e lagjes. Përkundrazi, lagjja ra në zi për Dafinën, kur mori vesh që ajo u hodh në ujërat e përroit dhe u mbyt, për t'u pastruar nga «turpi». Përroi, në jug të lagjes sonë, ku u mbyt Dafina, mori emrin e kobshëm, Përroi i Zi...

(2009)

## Profile

## ZHAN KOKTO, ARKETIP I AVANGARDISTIT

**Veprat e Zhan Koktosë ekspozohen në galeritë e famshme botërore të artit, si në Muzeun e Artit Modern të Nju Jorkut, tek Galeria Kombëtare në Uashington DC dhe në Institutin e Artit Courtauld të Londrës**

## Grigor JOVANI

Erdhi në jetë në periferinë Maizon - Lafit të Parisit dhe u nda prej saj në një periferi tjetër të kryeqytetit frëng, në Mili la Fore, 74 vjeçar. Rridhte nga një familje e pasur dhe u edukua në Liceun Kontorse. Qe më tepër autodidakt, tërhiqte më shumë miqtë dhe të njohurit me stilin karakteristik, në dukje të parë të shkujdesshëm, por thellësisht të informuar nga njohuritë që kishte për kubizmin, psikoanalizën dhe katolicizmin. "Poetët nuk vizatojnë, - tha dikur për veprat e artit, - shpalosin dorëshkrimin e tyre, pastaj e mbledhin prapë, por ndryshe..."

Ka qenë një artist poliedrik në kohën midis dy luftërave botërore, anëtar i avangardës franceze. Poet, romancier, dramaturg, piktor dhe regjisor kinematografik. Iu përkushtua Teatrit Psikologjik dhe u përfshi në rrymën e neoromantizmit. Pasioni i tij ishte rindërtimi dhe interpretimi hiper-realist i miteve të antikitetit grek, siç qenë ato të Edipit, Orfeas, Antigoni etj. Ndër veprat më të shquara kinematografike ka "Bukuroshja dhe Bisha" edhe "Prindër të tmerrshëm" (sipas veprës teatrore).

I talentuar qysh herët në artet, sidomos në ato të shkrimit, Kokto botoi përmbledhjen e parë poetike më 1909, të titulluar "Llamba e Aladin" (La Lampe d' Aladin). Ishte vetëm 18 vjeçar. Bota frënge e Letrave ia provoi talentin e dukshëm edhe në përmbledhjet e tjera poetike: "Princi i paqëndrueshëm" (1910), "Vallja e Sofokleut" (1912) dhe "Kepi i Shpresës së Mirë" (1919). Ajo që ra më tepër në sy në këto libra ishte brishtësia e ndjenjave, stili origjinal dhe fantazia e pasur.

Hiret poetike i transmetoi edhe tek proza. Zaten, tek gjithë vepra e tij, sidomos tek romanet, por edhe tek botimet filozofike dhe eseistike, ndihet një ndjenjë naiviteti fëmijëror, bashkë me agoninë e përhershme të kërkimit. Shembulli më i mirë janë romanet "Thoma mashtruesi" (Thomas l' imposteur, 1923) dhe "Fëmijë të tmerrshëm" (Les Enfants terribles, 1929). Viti 1923 shënon startimin në Teatër, me veprën "Të porsamartuarit e Purgut Ejfel" (Les Mariés de la Tour Eiffel). Këtu ndihet tendenca e tij karakteristike: një prirje largimi nga stili i realizmit që mbizotëronte dramaturgjinë dhe zhvillimi i vlerës së vetë-qëllimit në artin teatror. Në vazhdim u shpall në favor të ideve më novatore, mbështet artistët avangardistë dhe shfaqet gradualisht ihtar i "izmave" që kaluan mbi fytyrën e artit frëng të kohës: futurizmit, surealizmit, kubizmit dhe dadaistizmit: Të kësaj periudhe janë veprat e njohura: "Romeo dhe Zhuljeta" (1924), "Orfeu" (1927), "Antigoni" (libret për operën e Honegerit) dhe "Edipi tiran" (libret për operën e Igor Stravinskit) - të dyja më 1928. I ndikuar prej rrymës surealiste dhe avangardistët e artit abstrakt në pikturë dhe skulpturë, Kokto eksperimenton transferimin e këtyre ideve dhe praktikave në teatër. Kështu lindën veprat "Parada" (1917) me skenograf Pablo Pikasonë dhe muzikë nga Erik Satie, si edhe "Kau në çati" (1920) me skenografi të Dufusë dhe muzikë nga Darius Milo. Për sa i përket letërsisë, vepra e Koktosë u ndikua nga Edmon Rostan, Raimon Radige, kontesha de Noaiy, por mbi të gjithë nga Andre Zhid, me të cilin e lidhi një miqësi e madhe dhe produktive. E veçanta është se Kokto nuk u njafua



me shkrimin e veprave, mori pjesë edhe vetë në ngjitjen e tyre në skenë, si aktor, producent, skenograf. Për nevojat e skenës shkroi edhe skenarë baleti, cirku, muzikale, skenarë kinematografikë (siç qe ai për filmin surealist "Bukuroshja dhe bisha"). Bashkëpunoi me emra të famshëm të arteve të ndryshëm, si Fransua Kopo, kompozitorin Artur Honeger, piktorët e mëdhenj të kohës Pikaso dhe Modiliani, me koreografin dhe regjisorin e madh rus, Serzh Diagilev, krijuesin e "baleteve ruse" etj. Duhet theksuar këtu miqësia e tij e gjatë me Pablo Pikason, biles ishte kumbarë në dasmën e piktorit avangardist spanjoll me Olga Hohlovën. Miq të tjerë të famshëm të Koktosë qenë edhe Marsel Prusti, Andre Zid dhe stërnipi i Viktor Hygosë, Zhan. Prej vitit 1937 e gjersa vdiq e lidhte një miqësi e ngushtë (edhe erotike) me aktorin e njohur Zhan Mare.

Vdiq më 1963, një ditë pas Edit Piafit. Shiko ç'trille të çuditshme luan fati: Zhan Kokto dhe Edit Piaf ishin njohur më 1940, kur Piaf luajti mrekullueshëm "Të bukurën e pakorruptuar", që Kokto e kishte shkruar posaçërisht për të. Andej e tutje i lidhi një miqësi e pandarë. Bashkë shkuan në përjetësi, me një ditë diferencë. Sot veprat e Zhan Koktosë ekspozohen në galeritë e famshme botërore të artit, si në Muzeun e Artit Modern të Nju Jorkut, tek Galeria Kombëtare në Uashington DC dhe në Institutin e Artit Courtauld të Londrës.

## DEKALOGU I KOKTO-së

Shkrimtari dhe artisti i famshëm Zhan Kokto u bë personalitet i rëndësishëm i kulturës frënge qysh në të 17-tat e tij. Stigmatizoi epokën e vetë me kureshtjen e pashuar, me dëshirën për të eksperimentuar të renë. Shumë gjëra mund të thuhet për të, por si të biem në një "rezymë" sa më të saktë se kush ishte? Kritika frënge dhe ajo botërore e artit ka zbuluar 10 gjëra, ku mund të mbështetemi, për të njohur sa më mirë

këtë artist të jashtëzakonshëm.

1. RITI I PRANVERËS. Më 1913 Kokto pa premierën e "The Rite of Spring", baletit të famshëm që veshi me muzikën e tij Igor Stravinski. I tronditur nga një shfaqje e tillë novatore, që nuk përputhej me rregullat ekzistuese të krijimit, ajo ishte një zbulim i madh për Koktonë. Pasi përjetoi këtë atmosferë, Kokto shkroi dhe ilustroi veprën "Le Potomak", e cila konsiderohet vepra e tij e parë e rëndësishme. Më vonë ka shkruar: "Puna ime fillon me "Le Potomak", është si të thuash prologu".

2. ARTI I KURIOZITETIT. Ç' nuk përmbante menyja e tij artistike! Shkrimtar, piktor, kineast, skenarist, skenograf... Arketipi i artistit poliedrik! Provoi talentin edhe tek mozaikët, qeramikën, gjer edhe tek mjeshtëria e tekstileve, sikundër është tapeciria. Edhe pse e konsideronte veten në radhë të parë poet, arti i tij është mbi të gjitha ai i... surprizave. Ky art e ka zanafillën kryesisht prej... kureshtjes.

3. AFËRSIA E DHIMBSHME ME VDEKJEN. Erdhi në kontakt me vdekjen në një moshë të vogël, i ati iu vetëvra kur ishte vetëm 9 vjeç. Vite më vonë humbi një mik të afërt, prozatorin dhe poetin Raymond Radiguet, që vdiq më 1923, duke zhytur Koktonë në një dëshpërim të thellë. Megjithë mundimet që i ka shkaktuar vdekja, ballafaqimi dhe përballimi i dëshpërimit e mbushi njëkohësisht me një mirënjohje të thellë për jetën. Kjo u shpreh mrekullueshëm në veprën e tij.

4. ZHAN MARE & ZHAN KOKTO - NJË TAKIM DASHURIE DHE KRIJIMTARIE. Gjatë një audicioni për "Edipin mbret" më 1938, Koktoja njohu aktorin e famshëm frëng Zhan Mare. Mare ishte 24 vjet më i ri se ai. U mrekullua prej tij dhe u dashuruan reciprokisht. Ishte njëkohësisht edhe zanafilla e një bashkëpunimi të bukur artistik. Vitin që u njohën, Kokto shkruante "Prindërit e tmerrshëm", që kur u ngjit në skenë nxiti së tepërmi karrierën e Maresë. Pastaj, prej këtij bashkëpunimi lindën "Përbindëshat e shenjtë", "Bukuroshja dhe

bisha" dhe "Kthimi i përjetshëm".

5. PRODHUES PRODUKTIV DHE I PALODHUR. Ishte i pashtershëm dhe shumë prodhimtar. Një makinë krijimtarie. Kishte aftësinë të shkruante kryevepra në kohë rekord. Kështu ndodhi me "Fëmijët e tmerrshëm", vepër që e shkroi për 17 ditë. Nëntë vite më vonë i erdhi radha "Prindërit të tmerrshëm", që e përfundoi për 8 ditë.

6. FITUES I RREGULLT ÇMIMESH. Fama e talentit të Koktosë u shpërblye në mënyra të ndryshme. Natyrisht, me çmime të shumta e të shpeshta. Mori "Legjionin e Nderit" më 1949 dhe ishte anëtar i Këshillit Kritik të Festivalit Ndërkombëtar Kinematografik të Kanës katër vjet më vonë. Më 1955 u bë anëtar i Akademisë Franceze, kur mori vendin e Jérôme Tharaud.

7. DEMONËT: HIDHËRIMI DHE VARTËSIA PREJ TIJ. Dashuria e parë e Koktosë dhe mbase më e rëndësishmja ishte Raymond Radiguet. Hidhërimi për vdekjen e tij e zhyti në një depresion të thellë. Filloi të merrte opium. U shtrua në një klinikë, por nuk arriti kurrë ta ndalojë. Shumë vepra që shkroi ("Shtëpia e shëndetit", "Opium", "Ditari i një kurimi") janë dëshmitare të marrëdhënies që kishte me narkotikët, i përpjekjeve pa sukses për t'u çliuar prej tyre.

8. IKONË E KOHËS SË VETË. Asnjë bashkëkohës nuk vuri në dyshim talentin e Koktosë. Qysh nga 1909-a njohu sukses të madh. Ishte takimi i tij i parë me Édouard De Max, i cili i hapi portat e botës letrare dhe artistike. Dhe ku, në Parisin e qindra erërave artistike nga e gjithë bota... Gradualisht u bë mik dhe bashkëpunëtor i njerëzve më të mëdhenj të artit në atë kohë: Apollinari, Coco Chanel, Marcell Prust, Pol Elyard, Edit Piaf, Toso e shumë të tjerë. Fakt është se Kokto u çmua shumë nga bashkëkohësit.

9. NJË FËMIJË I PËRJETSHËM. Edhe aty nga fundi i jetës së vetë, Kokto linte shpirtin e tij fëmijëror të fliste. Kishte ruajtur një mënyrë të çrregullt jetese, që i karakterizonte vitet e fëmijërisë. Edhe në moshë të shkuar, e mahnisnin basmat dhe tapiceritë me stampa panterash. Edhe trupin e vetë kishte vizatuar me këto motive...

10. LETËRSIA - ARRATISJA E TIJ. Ishte një karakter shumëplanësh dhe i ndërlikuar. Eksploruës, i zhvilluar, i munduar, i tejndjeshëm. Rizbulon vetveten vazhdimisht, për të shijuar sa më mirë artin. Por jo gjithmonë mirëqenien e tij personale. Letërsia e tij brilante funksionoi si shërim në jetë. Ishte një arratisje e vërtetë nga realiteti, e ndihmoi të përballonte shumë vështirësi.

## REZYME

Avangardist i vendosur, Kokto stigmatizoi epokën e tij me mënyrë origjinale. Akoma edhe sot vepra që krijoi arrin të prekë dashamirët e artit dhe letërsisë kudo në botë, i frymëzon të tentojnë novatoren. Të tejkalojnë vetveten. Mbi të gjitha, Kokto të jep mundësinë të shikosh përtej fenomeneve. Sepse, siç i pëlqente të thoshte: "Pasqyrat do të ishte mirë të reflektonin ca më shumë, para se të na kthenin pas ikonat..."

(Athinë, tetor 2024)

Digjitalizimi

# NJË MAKINË SHKRIMI PËR TË KONKURRUAR SHKRIMTARËT E FEJSBUKUT

**Facebook-u dhe platforma të tjera ofrojnë një hapësirë të lirë për vetë-promovim, ku çdo autor mund të krijojë një imazh të ngarkuar me sukses të madh, ndonëse realiteti është krejt tjetër**

**Leonard VEIZI**

Çfarë i ka gjetur shkrimtarët sot? Si në një mynxyrë ku rrokullisen pandalshëm gurë të rëndë ortekësh, ata kanë humbur lexuesit në mënyrë drastike. E për këtë shkak, - sipas një kolapsi ku kërkohet ndihmë emergjente me sinjale akustike e drita verbuese, - i janë drejtuar Facebook-ut. Të bindur se kjo platformë, që tallet me ne e na e ka futur kokën në bigë, do t'i shpëtojë. Dhe kjo situatë absurde i përshtatet fort asaj shprehjes se ai që po mbytet nuk shpëton dot duke u kapur pas valëve të detit. Vetë shkrimtarët kanë lënë mjetet e vjetra e primitive të komunikimit - ndonjë pendë palloi e kallamaren me bojë, - dhe i janë përveshur digjitalizimit. E kërkon koha, themi po ne që e shajmë digjitalizimin po duke përdorur mjete digjitale. Sepse është e pamundur të përdorësh mjetet e vjetra. Por në fakt, të gjithëve u duhet nga një makinë shkrimi. Si ato "Olivet" që mbaheshin në çanta të vogla, po aq sa laptopët sot. Vetëm kështu mund të nisë konkurrimi i vërtetë, duke shkruar dhe një letërsi më të vërtetë. Në një botë të mbizotëruar nga teknologjia dhe lidhjet virtuale, ku çdo mesazh mund të dërgohet me një klik, çdo mendim të shpërndahet në sekonda, ekziston ende diçka thellësisht e fuqishme në përjetimin e dorës që shkruan mbi letër, apo zhurmën ritmike të një makine shkrimi që përplasat me fletën e bardhë. Këto mjete, që dikur ishin simbol i epokave më të hershme të komunikimit dhe mendimit të përpunuar, sot përfaqësojnë një akt rebelimi ndaj diktatit të teknologjisë moderne. Kur flasim për sistemin online, nuk mund të anashkalojmë fuqinë e shpejtësisë dhe efikasitetit që ai ofron. E-mail-et arrijnë në çast, artikujt publikohen me një klik në tastierë, dhe rrjetet sociale krijojnë komunitete globale që ndërveprojnë me shpejtësi. Megjithatë, ky përshpejtim i vazhdueshëm i procesit të krijimit ka ndikuar edhe në natyrën e mendimit tonë. Në një epokë ku gjithçka bëhet për t'u konsumuar sa më shpejt, ku lajmi i mëngjesit në drekë duket krejt i vjetruar dhe postimi i pasdites harrohet deri në mbrëmje vonë, çfarë ndodh me mendimin e thellë, reflektimin dhe artin e përpunimit të fjalës? Në këtë pikë hyn në skenë letra dhe makina e shkrimit. Ato përfaqësojnë ngadalësimin e qëllimshëm, një mënyrë për t'i dhënë mendimit hapësirën dhe kohën që meriton. Kur ulesh për të shkruar një letër, ndien peshën e fjalëve, rëndësinë e secilit rresht, sepse nuk mund t'i fshish lehtësisht, nuk mund t'i editosh pafundësisht. Po ashtu, makina e shkrimit kërkon një saktësi të lartë, një përkushtim të veçantë. Çdo fjali është një angazhim. Mirëpo të gjithë ne sot preferojmë teknologjinë. Shkrimtarët gjithashtu. Dhe shpresojnë që marketingun të mos ua bëjë më një person konkret me emër njerëzor por një mekanizëm industrial, me emër teknologjik që fshihet pas qarqesh e diodash apo hard-esh e softuer-esh. Në këto kohë moderne të High Tech-ut, një dukuri gjithnjë e më e përhapur në botën e letërsisë është ajo e shkrimtarëve që përdorin rrjetet sociale, si Facebook, për të promovuar veprat e tyre. Nëse dikur libra të caktuar gjenin lexues përmes librarive,



kritikëve apo ndikimit me fjalën e thënë, tani shumë autorë i drejtohen internetit për të krijuar lidhje të drejtpërdrejta me audiencën. Mirëpo, ajo që duket se po ndodh gjithnjë e më shpesh është se shkrimtarët, për shkak të shitjeve të dobëta apo mungesës së interesit, shpesh mburren në mënyrë të tepruar me librat e tyre. Ata përpiqen të krijojnë zhurmë virtuale, ndonjëherë në mënyrë të shtirur, për të kompensuar humbjen e kontaktit me lexuesit realë. E ku kanë përfunduar shkrimtarët, që dikur mbaheshin si ajka e shoqërisë. Facebook-u dhe platforma të tjera ofrojnë një hapësirë të lirë për vetë-promovim, ku çdo autor mund të krijojë një imazh të ngarkuar me sukses të madh, ndonëse realiteti është krejt tjetër. Një postim për një libër të ri shpesh shoqërohet me fryrje rreth përmbajtjes së tij, sukseseve që ndoshta nuk janë vërtetuar nga shitjet, dhe ndonjëherë me kritikë të mbështetur në referenca të vakëta apo miq të afërt. Paradoksi qëndron në faktin se, ndërsa librat nuk shiten në të njëjtat sasisime parë, shkrimtarët përpiqen ta kompensojnë këtë përmes krijimit të një narrative të mbushur me lavdërime virtuale. Kjo është si të thuash: të ngopesh me lugën bosh. Një shkrimtar i vërtetë i njëj kufijtë e letërsisë së tij dhe, më e rëndësishmja, e kupton rëndësinë e lexuesit të angazhuar. Mirëpo, përballë mungesës së reagimit

nga lexuesit dhe dështimit të shitjeve, disa autorë mbështeten te perceptimi virtual, që shpesh është më iluzion se sa realitet. Në këtë kuptim, Facebook-u shërben si një teatër për ata që nuk pranojnë të përballen me vështirësitë e tregut letrar modern. Kjo krijon një boshllëk të ndjeshëm: një shkrimtar që mburret për librin e tij në Facebook, pa e ditur ose pa dashur të pranojë se libri i tij, në të vërtetë, nuk po lexohet nga askush. Duket sikur çdo postim që mburret me një libër të ri është një thirrje për ndihmë, një përpjekje për të ruajtur një status që dikur ishte më i qëndrueshëm. Por në fund, vlera e një libri nuk përcaktohet nga sa shumë është shpërndarë apo pëlqyer në Facebook, por nga ndikimi që lë tek ata që e lexojnë. Në epokën digjitale, të kesh durimin të shkruash një letër me laps a penë, ose të përdorësh një makinë shkrimi, është një akt radikal. Është një mënyrë për të thënë se jo gjithçka ka nevojë për shpejtësi, jo çdo mendim duhet të jetë i përkohshëm. Letra dhe makina e shkrimit nuk konkurrojnë me teknologjinë moderne në aspektin e shpejtësisë apo aksesit, por përkundrazi, sfidojnë natyrën e konsumit të shpejtë, duke i dhënë një zë të ri thellësisë dhe vëmendjes. Ato përfaqësojnë një mënyrë të re, të vjetër, për të krijuar dhe për të ndarë mendime, një mënyrë që u bën thirrje ndjenjave dhe kujtimeve të një kohe kur fjala kishte peshë më të madhe. Një

letër e shkruar me dorë ose në një makinë shkrimi nuk është vetëm një mesazh - ajo është një përvojë, një reflektim i mendimeve dhe emocioneve të autorit. Në kohën kur gjithçka është e hapur për publikun dhe informacioni është i aksesueshëm në çdo moment, një letër apo një dorëshkrim përfaqëson një intimitet dhe një autenticitet që teknologjia e sotme nuk mund ta rivalizojë. Pra, ndonëse në sipërfaqe duket si një garë e pabarabartë mes mjeteve tradicionale të shkrimit dhe sistemit online, ajo çfarë letra dhe makina e shkrimit sjellin në këtë "konkurrencë" është një mënyrë tjetër e të menduarit. Ato i sfidojnë individët të ndalen, të reflektojnë dhe të krijojnë diçka me kuptim të përherëshëm. Dhe pikërisht në këtë qëllim, ato triumfojnë mbi çdo sistem dixhital që shpërndan fjalë me shpejtësi marramendëse por shpesh pa thellësi. Në fund të fundit, konkurrenca nuk qëndron në kapacitetin për t'i tejkaluar kufijtë teknologjikë të botës online, por në fuqinë për të ruajtur atë që është njerëzore - lidhjen e vërtetë, përvojën fizike të krijimit, dhe përkushtimin ndaj artit të mendimit. "Hey guys", largohuni nga Facebook-u. Ai është për të hedhur staturë me pak kripë e një çikë piper, por nuk ka të bëjë me mendimin e konsoliduar, të cilin keni marrë përsipër ta hidhni nga truri brenda kokës tuaj, në një fletë të bardhë.

NUMRI I ARDHSHËM MË 15 NËNTOR

# HEJZA

30 Tetor 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:  
**Drian Shala - Shala & Rexhepi**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000